

**UNIVERSITETI I EVROPËS
JUGLINDORE**



**FAKULTETI I SHKENCAVE
SHOQËRORE BASHKËKOHORE**

STUDIMET PASDIPLOMIKE-CIKLI I DYTË

TEMA:

**LËVIZSHMËRIA E STUDENTËVE SI INSTRUMENT I
DIPLOMACISË KULTURORE**

KANDIDATJA:
Blerina Pollozhani

MENTORI:
Prof. Memet Memeti

Tetovë, Mars, 2021

PËRMBAJTJA

TEMA:	1
ABSTRAKTI	1
1.HYRJE	3
1.1. Qëllimi i hulumtimit	4
1.2. Hipotezat	5
1.3. Metodatat e hulumtimit	6
1.4. Struktura e tezës	6
2.KONCEPTET TEORIKE	8
2.1. Koncepti i diplomacisë publike	8
2.2. Komunikimi global	15
2.2.1. Rrjedha e lirë e informacionit	17
2.3. Qeveritë dhe individët si aktorë komunikimi	18
2.4. Roli i pushtetit të butë	22
2.5. Diplomacia kulturore	27
2.5.1. Imazhi i vendit	32
3.ARSIMI I LARTË DHE DIPLOMACIA PUBLIKE	42
3.1. Roli i shkëmbimeve studentore	44
3.2. Studentët si ambasador kulturor	48
4.POLITIKAT PUBLIKE DHE SHKËMBIMET STUDENTORE NË MAQEDONIN E VERIUT	50
4.1. Korniza institucionale arsimore në Maqedoninë e Veriut	50
4.1.1. Kuadri ligjor në arsimin e lartë në Maqedoninë e Veriut	52
4.2. Programet shkëmbimore në Maqedoninë e Veriut	53
5.STUDIMI EMPIRIK	60
5.1. Koncepti i lëvizshmërisë studentore si mjet i diplomacisë	60
5.2. Tejkallimi i stereotipeve	66
6.KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	69
6.1 Konkluzione	69
6.2 Rekomandime	71
7.BIBLIOGRAFIA	73
SHTOJCË	80

Unë e kam lexuar këtë temë dhe e aprovoj, dhe sipas mendimit tim është e përshtatshme në qëllim dhe cilësi për të fituar titullin Magjistre e Diplomacisë

Prof. Dr. Memet Memeti

Udhëheqës i punimit shkencor

Unë, Blerina Pollozhani, me përgjegjësi të plotë morale dhe penale deklaroj që ky punim është punim origjinal i imi dhe nuk përmban materiale të autorëve dhe burimeve tjera, me përjashtim të materialave të huazuara nga autorë të tjerë të cilët janë cituar konform standardeve ndërkombëtare dhe politikave të UEJL. Për më tepër, deklaroj se pjesa e hulumtimit dhe studimit empirik është rezultat i punës sime dhe nuk është prezantuar apo publikuar më parë.

Mirënjohje

Falenderoj dhe u jam mirënjohëse përjetësisht familjes time që më dhanë mbështetje të pa kusht emocionale dhe financiare për të arritur shkollimin deri këtu.

Falenderoj babain tim Nafi Pollozhani (Doc.Dr. Ekonomi) dhe mamin Qibarete Pollozhani që më përkrahën dhe më besuan gjatë gjithë rrugëtimit në çdo sukses timin.

Mirënjohje të veçantë për mentorin Prof. Memet Memeti për ndihëm profesionale dhe këshillat e dhëna drejt ngritjes së nivelit të punimit.

ABSTRAKTI

Synimi i punimit është të trajtohet tema në lidhje me rëndësinë që ka lëvizshmëria studentore në diplomacinë kulturore përmes programeve studimore. Tema i adresohet aspektit arsimor dhe institucional të cilat mundësojnë ndërkombëtarizimin e konceptit të edukimit. Shumë shtete të mëdha si në Shtetet e Bashkuara, Evropë dhe Mbretërinë e Bashkuar e kanë vërtetuar rolin e tyre me ndikim kombëtar dhe ndërkombëtar. Përmes programeve të pushtetit të butë dhe edukimit ndërkombëtar si kontribues kryesor janë krijuar mekanizma të cilat përdoren për të promovuar politika kombëtare dhe interes për të kontribuar në zhvillimet dhe investimet e vendit. Përmes këtyre politikave të përdorura nga pushteti i butë, lëvizshmëria dhe përvojat e studentëve, marrëdhëniet intelektuale dhe shoqërore në nivele akademike në kulturë, vlera dhe ide kanë ndikuar në zhvillimin dhe imazhin e vendit në skenën globale.

ABSTRACT

The aim of the paper is to address the topic related to the importance of student mobility in cultural diplomacy through study programs. The topic addresses the educational and institutional aspect which enables the internationalization of the concept of education. Many large states like the United States, Europe and the United Kingdom have proven their role with national and international influence. Through soft power programs and international education as key contributors have been established mechanisms which are used to promote national policies and interest to contribute to the country's development and investment. Through these policies used by soft power, student mobility and experiences, intellectual and social relationships at academic levels in culture, values and ideas have influenced the development and image of the country on the global stage.

АБСТРАКТ

Целта на трудот е да се осврне на темата поврзана со важноста на мобилноста на студентите во културната дипломатија преку студиски програми. Темата се осврнува на образовниот и институционалниот аспект што овозможува интернационализација на концептот на образование. Многу големи држави како во САД, Европа и Велика Британија ја докажаа својата улога со национално и меѓународно влијание. Преку меки програми и меѓународно образование како клучни соработници се воспоставени механизми кои се користат за промовирање на националните политики и интерес на придонесување развој и инвестиции на земјата. Преку овие политики користени од меката моќ, мобилноста и искуствата на студентите, интелектуалните и социјалните односи на академско ниво во културата, вредностите и идеите влијаеја на развојот и имиџот на земјата на глобалната сцена.

1. HYRJJE

Në periudhën e sotme komunikimi përdor disa strategji, teori dhe teknologji për një komunikim sa më efektiv në diplomacinë publike. Nevoja e komunikimit është një shtysë e interesit dhe sigurimit kombëtar përmes të kuptuarit, informimit dhe ndikim në publikun e huaj, dhe zgjerimi i dialogut midis qytetarëve dhe institucioneve, dhe homologëve të tyre jashtë vendit. Komunikimi theksohet si një aspekt thelbësor i diplomacisë. Mirëpo kur flasim për komunikimin në diplomacinë publike nënkuptojmë atë që ajo çka flitet dhe shkruhet duhet të jetë e kuptueshme për auditoriumin, që tregon të vërtetën rreth të dhënave që jepen qartazi dhe drejtëpërdrejtë. Kështu diplomacia publike ka marrë një rëndësi të madhe në zhvillimin e politikës së jashtme. Vendet që zbatojnë Diplomacinë Publike bazuar në ‘mobilizimin e potencialit aktual të pushtetit të butë’¹ (arsim, kulturë, sport etj.), arrijnë të bëjnë që vendet dhe shoqëritë e tjera të adoptojnë politikat e tyre. Në një kontekst të tillë, rregullat që duhet të ndiqen do të jenë: të miratohet një sjellje në përputhje me kulturën pritëse dhe protokollin në tokat e huaja; krijimi i një komunikimi efektiv ndërkulturor; të negociojë në një kontekst të komunikimit ndërkulturor; komunikojnë në mënyrë diskrete për kulturën e tyre të origjinës; të identifikojë ndikimet e kulturës së vet brenda komunikimit ndërkulturor; tejkalimi i barrierave kulturore dhe gjuhësore. Në dritën e globalizimit në shekullin e njëzet-e-një, bizneset po kërkojnë punonjës me aftësi që do t'i bënin ata më konkurrues në arenën ndërkombëtare. Prandaj, të diplomuarit në universitete duhet të kenë aftësinë për të bashkëvepruar me njerëz nga kultura të tjera dhe prejardhje të ndryshme² për të qenë të suksesshëm në tregun ndërkombëtar të punës. Atyre u kërkohet të punojnë në ekipe multikulturore dhe të flasin gjuhë të tjera. Kjo krijon sfida të reja për institucionet e arsimit të lartë³. Universitetet duhet të përgatisin studentët e tyre për një mjedis të tillë të globalizuar, duke mundësuar kështu që të diplomuarit e tyre të jenë më të punësueshëm. Ekziston një presion në rritje mbi fakultetin dhe administratën e universiteteve për të ndërkombëtarizuar kampuset, programet mësimore dhe klasat e tyre. Ata duhet të përgatisin studentët e tyre për punën globale dhe qytetarinë globale. Institucionet, programet dhe kurset e tyre duhet të pozicionohen për të ndihmuar globalizimin e mjedisit të arsimit të lartë dhe për t'i përgatitur studentët për tregjet globale. Organizata e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Zhvillimit (OECD)

¹ Nye, S.J. (2005). *Soft Power: The Means to Success in World Politics*. New York: Public Affairs

² Fantini, A. E., Arias-Galicia, F., & Guay, D. (2001). *Globalization and 21st century competencies: Challenges for North American higher education*, 2018, <http://conahec.org>

³ Rizvi, F. (2006). Internationalization of curriculum: A critical perspective. In *The SAGE handbook of research in international education*, 2006

përcakton një kurrikulë të ndërkombëtarizuar si një program i cili ka një "orientim ndërkombëtar në kontekst, që synon përgatitjen e studentëve për shfaqje në një kontekst ndërkombëtar dhe multikulturor, dhe i krijuar për studentë vendas, si dhe studentë të huaj⁴. ” Një nga metodat më efektive të zhvillimit të një përvoje ndërkombëtare është që studentët të bashkohen në një program shkëmbimi studentësh ose të studiojnë jashtë vendit për një ose dy semestra. Programet e tilla i ndihmojnë studentët të jenë individë shumëgjuhësh me kompetenca ndërkulturore dhe të zhvillojnë miqësi të qëndrueshme në vendet e tjera duke kontribuar në paqen në botë⁵. Për shkak të këtyre përfitimeve, universitetet po përpiqen të zgjerojnë programet e tyre të shkëmbimit të studentëve dhe të inkurajojnë studentët e tyre të marrin pjesë në programe të tilla. Për shembull, Bashkimi Evropian po siguron mbështetje financiare për Universitetet Evropiane në 37 vende për lëvizjen e studentëve përmes programit Erasmus⁶, duke mundësuar shkëmbimin e studentëve në mbi 900 universitete partnere. Për më tepër, shumë universitete ofrojnë kurse të gjuhës së dytë ose të tretë për t'i bërë të diplomuarit e tyre në shumë gjuhë. Në disa universitete, kurse të tilla janë madje një kërkesë për diplomim. Rekrutimi i studentëve më të ndryshëm ndërkombëtarë dhe etnikisht është një përparësi për universitetet me një qëllim serioz ndërkombëtarizimi. Integrimi i studentëve ndërkombëtarë me studentët vendas ndihmon në rritjen e përvojës ndërkulturore të të gjithë studentëve.

1.1.Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi është: të sigurojë ndikimin që ka komunikimi në marrëdhëniet ndërkombëtare në diskursin teorik, diplomatik, arsimor dhe kulturor; dhe hulumtojë kërkime të mëtutjeshme të shëmbimeve studentore. Fusha në të cilën do të fokusohet studimi janë shkëmbimet arsimore. Studimi do të fokusohet në edukimin ndërkombëtar dhe rëndësia që mund të ketë në diplomacinë publike. Duke pasur parasysh pushtetin e butë si një kontribues kryesor dhe fushë e diplomacisë publike e cila mund të krijojë mundësi të prodhimit të vlerave dhe interesave politike të jashtme të vendit, zhvillim kulturor dhe arsim. Edukimi ndërkombëtar në rolin e tij si aktor politik, tërhiqet fort nga koncepti i pushtetit të butë. Rreth një dekade më parë, Jospeh Nye pushtetin e butë e

⁴ Organisation for Economic Co-operation and Development., *Internationalizing the curriculum in higher education*, 1996

⁵ Clinton, W. J. , *Proclamation international education week*. Washington, DC: The White House, 2000

⁶ European Union. Erasmus programme. <http://www.erasmusprogramme.com>. Accessed September, 2018

përshkruajti si aftësia për të ndikuar tek të tjerët dhe për të arritur vetë-interesim ndërkombëtar përmes tërhqjes dhe bindjes sesa përmes detyrimit, forcës ushtarake ose sanksioneve ekonomike—të njohura si pushtet i fortë. Edukimi ndërkombëtar luan një rol të rëndësishëm në diplomacinë publike veçanërisht në komunikimin ballë për ballë me shtetet tjera e cila ndihmon në parandalimin e stereotipeve dhe lehtëson komunikimin ndërkulturor. Programet shkëmbimore përdoren si mekanizma të politikës publike nga përvojat e lëvizjeve të studentëve, ideve dhe marrëdhëniet sociale dhe intelektuale në nivele akademike për të forcuar imazhin e vendit. Përkufizimet e diplomacisë publike sillen nga komunikimi në një drejtim të shpejtë përmes një komunikimi masiv, deri tek modelet, bazuar në konceptin se komunikimi i dyanshëm është metoda më e mirë për të ndryshuar dhe informuar pikëpamjet e publikut. Analizat e komunikimit ndërkombëtar ose diplomatik arrihen në tre nivele si kanalet komunikative, sinjale-mesazhe dhe sisteme ndërkombëtare ose rrjetet. Këto janë qëllimet e diplomacisë publike: Informimi dhe manipulimi i opinionëve të huaja publike; rritjen e këtij efekti; korrigjimi i keqkuptimit dhe vendosja e bazës për një dialog të thellë ndër-shoqëror. Menaxhimi i Diplomacisë Publike, bazuar në komunikimin dhe ndërveprimin reciprok, përfiton kryesisht nga elementët e fuqisë së butë si kultura, arsimit, sporti etj., për krijimin e simpatisë së ndërsjellë. Synohet në këtë qasje që të krijohet mirëkuptimi i ndërsjellë midis vendeve dhe shoqërive duke përdorur elemente të pushtetit të butë intensivisht.⁷ Ndërsa në qasjen fleksibël, aktivitetet afatgjata fitojnë rëndësi, krijohet një atmosferë për mirëkuptim reciprok duke përfituar nga mundësitë e arsimit, stilet e jetës, sistemet politike dhe ekonomike dhe aftësitë artistike.⁸

1.2. Hipotezat

Teori të ndryshme tregojnë se edukimi ndërkombëtar po bëhet një trend përfaqësues me një influence diplomatike që lidh vendet me aktor jo shtetëror për të kuptuar kulturën, qëndrimet dhe sjelljen, për të krijuar dhe menaxhuar marrëdhënie të mira mes vendeve, dhe gjithashtu të ndikojë në idetë dhe veprimet për të çuar interesat dhe vlerat e tyre para.

Gjithashtu konceptualizimi i edukimit ndërkombëtar i referohet një dinamike që përfshin lëvizjen e individëve, opinionit dhe ideve përtej kufijve politikë dhe kulturorë. Pra,

⁷ Signitzer, B., Wamser, C., "Public Diplomacy: A Specific Governmental Public Relations Functions". *Public Relations Theory II*. (Der.) Carl Botan ve Vincent Hazelton. New Jersey: Lawrence Erlbaum, 2006

⁸ Yagmur, A., "Halkla İlişkiler Yönetimi Olarak Kamu Diplomasisi". *İletişim Araştırmaları Dergisi*. Ankara, 2007

edukimi ndërkombëtar si diplomaci publike ndjek dhe eksploron më afër strukturat ndërkombëtare të cilat ju mundësojnë vendeve dhe institucioneve, rrjeteve dhe shtet kombeve të lidhen, përfshihen, shkëmbejnë dhe bashkëpunojnë duke mbajtur marrëdhënie të mira ndërkombëtare.

Mirëpo nëse fokusohemi në atë se programet shkëmbimore mund të përcjellin hapat politike të një vendi tjetër nga i ashtuquajtimi pushteti i butë, siç përmend dhe Nye, që ndryshimet shoqërore dhe politike në botë kanë ndodhur në dy shekujt e fundit duke krijuar të ashtuquajturin “aftësia e diktimit të veprimeve të tjetrit”. Organizatat ndërkombëtare, OJQ dhe institucionet akademike janë mekanizma të diplomacisë publike të cilat mund të bëjnë promovimin e kulturave, vlerave politike dhe politikat e jashtme përmes aktorëve jo shtetëror dhe opinionit publik. Gjithashtu mund të ndikojë në thellësimin e dialogut dhe vendimarrjeve në mes qytetarëve të tyre dhe qytetarët e huaj të shoqatave dhe organizatave ndërkombëtare.

1.3. Metodatat e hulumtimit

Gjatë këtij studimi do përdoren metoda përshkruese dhe krahasuese. Në teknikën hulumtuese dhe materialet të cilat do të përdoren, do të merren nga zyrat për ligje, programe dhe strategji, si dhe marrja e të dhënave nga hulumtime të tjera të rasteve studimore. Studimi do të përfshijë dy metoda atë teorik dhe praktike. Si studim praktik është anketa, ku janë të parashtruara 15 pyetje, dhe janë përgjigjur gjithsej 50 studentë nga institucionet e arsimit të lartë në Maqedoninë e Veriut. Prandaj dhe duke marrë si bazë pyetësin historikisht edukimi ndërkombëtar si disiplinë i atribuohet nismave ndërkombëtare dhe ndërkontinentale të së kaluarës, të cilat synonin të arrinin arsimimin, mësimin dhe shkëmbimin intelektual. Programet e suksesshme edukative në vendet si Shtetet e Bashkuara, Kanada dhe shtetet Evropiane, kanë vërtetuar rolin dhe rëndësinë e ndikimit të tyre në interesin kombëtar dhe qëllimet ndërkombëtare të pushtetit të butë. Synimi përmes këtij pyetësi online do të indentifikohen faktorët të cilët mund të shtyjnë në vendimin e studentëve për të studiuar jashtë vendit dhe do të mblidhen të dhënat të cilat do të analizohen.

1.4. Struktura e tezës

Në kapitullin e parë të tezës do të shpjegohen qëllimi dhe fusha, hipotezat, metodat e hulumtimit dhe struktura e tezës. Në kapitullin e dytë do përkufizohen konceptet teorike të diplomacisë publike dhe zhvillimi i saj përmes komunikimit, duke pasur parasysh rolin e saj

në përgjithësi dhe objektivat e përdorura gjatë zhvillimit të saj. Në kapitullin e tretë do të definohet arsimi i lartë në diplomacinë publike, dhe promovimi i shkëmbimeve arsimore, duke konsideruar studentët si organizma kyç të diplomacisë së sotme, të cilët përmes pushtetit të butë i japin një dimension tjetër diplomacisë publike. Në kapitullin e katërt do të shpjegohen konceptet për lëvizshmërinë e studentëve.

2. KONCEPTET TEORIKE

2.1. Koncepti i diplomacisë publike

Diplomacia publike është një fushë e Diplomacisë, e cila në vete përfshin bashkëveprimin jo vetëm mes qeverive, por edhe mes individëve, apo organizatave joqeveritare. Diplomacia publike synon promovimin e interesave kombëtare të një vendi, e cila arrihet përmes informimit të audiencës së huaj, me qëllim të ndikojë në të. Edmund Gullion në vitin 1965, për herë të parë përshkruan këndvështrimin e tij për diplomacinë publike duke e përshkruar: *‘Diplomacia publike merret me ndikimin e qëndrimeve të publikut në formimin dhe ekzekutimin e politikave të jashtme. Ajo përfshin dimensione të marrëdhënieve ndërkombëtare përtej diplomacisë tradicionale; kultivim nga qeveritë e opinionit publik në vendet e tjera; vendi me një vend tjetër; raportimi i punëve të jashtme dhe ndikimi i saj në politikë; komunikimi, puna e të cilëve është komunikimi si për diplomatët dhe korrespondentët e huaj; dhe procesi i komunikimeve ndërkulturore’*.⁹

Në kongresin amerikan për herë të parë koncepti i Diplomacisë publike u përmend në raportin e Komisionit Mërfi, në vitin 1977, e cila u përcaktua si ‘diplomacia kulturore’, ‘diplomacia e re’ dhe si ‘dimensioni i katërt i politikës së jashtme’. Historikisht termi ‘diplomacia publike ka qënë prezente në marrëdhëniet ndërkombëtare në të gjithë kohërat, por asaj thjesht i është dhënë një emër i ri për shkaqe të paqartësisë të saj’, duke u shprehur kështu në kongresin amerikan kreu i komitetit për çështje të jashtme D. Fossell. Pitologu amerikan Joseph Nye studioj më detajisht konceptin e diplomacisë publike, duke thënë se ‘diplomacia publike është një ndër metodat më efektive të rritjes së potencialit të pushtetit të butë’.¹⁰

Hulumtimi sistematik i çdo teme të rëndësishme së pari kërkon një përkufizim të zbatueshëm dhe të pranuar gjërisht. Studiuesit dhe praktikuesit kanë përdorur një shumëllojshmëri të përkufizimeve konfuze, jo të plota ose problematike të diplomacisë publike. Përkufizimet e mëparshme paraqisnin vetëm deklaratat të përgjithshme për qëllimet. Malone në një deklaratë tipike do të përshkruante diplomacinë publike si ‘komunikim të drejtpërdrejtë me popujt e huaj, me qëllim të ndikimit në të menduarit e tyre dhe, në fund të fundit, në atë të qeverive të tyre’.¹¹ Ky përkufizim nuk thotë kush e kontrollon këtë

⁹ F. Delaney, Robert, Gibson, John S., ed American Public Diplomacy: The Perspective of Fifty Years Medford Mass: The Edward R. Murrow Center of Public Diplomacy, Fletcher School of Law and Diplomacy/Lincoln Filene Center for Citizenship and Public Affairs, 1967,

¹⁰ Nze Jr, Joseph S The Power to Lead, Leadership e potere – hard, soft, smart power, Roma: LAterya, 2010

¹¹ D Malone, Gifford, Managing Public Diplomacy, 1985

komunikim, ndoshta për shkak të nocionit të mbajtur gjërësisht në vitet 1980 se vetëm qeveritë përdorin diplomacinë publike. Përkufizimi sugjeron gjithashtu një proces ndikimi me dy hapa: së pari, komunikimi i drejtpërdrejtë i krijuar për të krijuar një opinion mbështetës publik në një shtet tjetër; dhe së dyti, presion nga publiku i informuar mbi qeverinë e saj për të zbatuar politika miqësore ndaj vendit që përdor diplomacinë publike.

Përkufizimet e mëvonshme identifikuan aktorët dhe përmbajtjen. Tuch¹² për shembull, e përcaktoi diplomacinë publike si ‘një proces qeverie komunikimi me publikun e huaj në përpjekje për të sjellë mirëkuptim për idetë dhe idealet e kombit të tij, institucionet dhe kulturën e tij, si dhe qëllimet dhe politikat e tij kombëtare’. Frederick shtoi informacione për përmbajtje specifike: ‘aktivitete, të drejtuara jashtë vendit në fushat e informacionit, arsimit dhe kulturës, qëllimi i të cilave është të ndikojë në qeveri të huaja, duke ndikuar në qytetarët e saj’. Studiuesit kanë aktualizuar përkufizimin e diplomacisë publike sipas zhvillimeve kryesore në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe komunikimet.

Karakteristikat dominuese	Diplomacia e vjetër publike	Diplomacia e re publike
1. Identiteti i aktorëve ndërkombëtarë	Shteti	Shteti dhe joshiteti
2. Mjedi teknik	Radio me valë të shkurtëra Gazeta shtypi Telefona fiks	Satelitë, internet, lajme në kohë reale Telefona celularë
3. Mjedi mediatik	Linjë e pastër ndërmjet sferës së lajmeve vendase dhe ndërkombëtare	Linjë e turbullt e sferës së lajmeve vendase dhe ndërkombëtare
4. Burimi i qasjeve	Rezultati i avokimit politik dhe teorisë propagandike	Rezultati i markave korporative dhe teorive lidhëse
5. Terminologjia	Imazhi ndërkombëtarë Prestigji	Pushteti i butë Brendi nacional
6. Struktura e rolit	Nga lart poshtë, aktorë të popujve të huaj	Horizontale, e ndihmuar nga aktorë
7. Natyra e rolit	Objektiv mesazhin	Ndërtimin e marrëdhënieve
8. Qëllimi i përgjithshëm	Menaxhimi i mjedisit ndërkombëtarë	Menaxhimi i mjedisit ndërkombëtarë

Tabela1. Diplomacia e vjetër publike dhe e re¹³

Konceptet si ‘diplomacia e re’, ‘diplomacia publike’ dhe ‘diplomacia mediatike’, përshkruheshin si koncepte të paqarta dhe të pasakta, dhe ishte e nevojshme që t'u jepeshin

¹² Tuch, Hans N., *Communicating With the World: U.S. Public Diplomacy Overseas*. New York: St. Martins Press the Institute for the Study of Diplomacy

¹³ Falk, Hartig, 2014. "New Public Diplomacy Meets Old Public Diplomacy – the Case of China and Its Confucius Institutes," *New Global Studies*, De Gruyter, faqe 331-352, Dhjetor

atyre kuptime më specifike. Rawnsley¹⁴ bëri dallimin në mes diplomacisë publike dhe asaj mediatike: ku së pari, ai përshkruajti politikbërësit të cilët përdorin mediat për të adresuar publikun e huaj; dhe së dyti ju drejtohen zyrtarëve të qeverisë. Bazuar në qëllimet dhe mjetet, Profesori Eytan Gilboa¹⁵ bëri dallimin midis diplomacisë publike ku aktorët shtetërorë dhe jo-shtetërorë përdorin median dhe kanalet e tjera të komunikimit për të ndikuar në opinionin publik në shoqëritë e huaja; diplomacia e mediave, kur zyrtarët përdorin median për të hetuar dhe promovuar interesat reciproke, negociatat dhe zgjidhjen e konflikteve; dhe diplomacia ndërmjetësuese e mediave, ku gazetarët përkohësisht marrin rolin e diplomatëve dhe shërbejnë si ndërmjetës në negociatat ndërkombëtare.

Në fillim të këtij shekulli, studiuesit dhe praktikuesit kanë filluar të përdorin termin ‘diplomaci e re publike’. Diplomacia e re publike paraqet një përpjekje për të rregulluar diplomacinë publike me kushtet e epokës së informacionit. Rhiannon Vickers sugjeroi që ‘Diplomacia e re publike mund të karakterizohet si një mjegullim i dallimeve tradicionale midis aktiviteteve të informacionit ndërkombëtar dhe vendas, midis diplomacisë publike dhe tradicionale, dhe midis diplomacisë kulturore, marketingut dhe menaxhimit të lajmeve.’¹⁶

Politologu Joseph S. Nye, diplomacinë publike e paraqet në tre dimensione, e cila për synim ka vendosjen e marrëdhënieve afatgjata, për të krijuar kushte të përshtatshme për politikën e një shteti:¹⁷

- a. Komunikimi i përditshëm, përmes së cilit sqarohet thelbi i vendimeve të politikës së brendshme e të jashtme të një shteti. Në këtë dimension përfshihet edhe përgatitja për luftën me krizat. Në rastin e ekzistencës së vakumit të informacionit pas një çështjeje të caktuar, kontrollin mund ta marrin të tjerë lojtarë të arenës ndërkombëtare.
- b. Komunikimi strategjik, që nënkupton diskutimin e temave më të rëndësishme politike për një vend të caktuar, që kanë lidhje me fushatat politike apo ato të reklamave.
- c. Zhvillimi i marrëdhënieve me individë të një shteti të huaj, me ndihmën e bursave, programeve të shkëmbimeve ndërshkolllore, seminareve, konferencave dhe aksesit në kanalet e informimit publik. Ky dimension cilësohet hapi i fundit vendimtar i

¹⁴ Melissen, Jan, *The New Public Diplomacy*, 2005

¹⁵ Gilboa, Eytan, “Searching for a Theory of Public Diplomacy.” *The ANNALS of the American Academy of Political and Social Science*, 2008

¹⁶ Vickers, Rhiannon, *The New Public Diplomacy: Britain and Canada Compared*, f. 151

¹⁷ Nye Jr., Joseph S. and Owens, William A. , *America's Information Edge. The Power Resource of the Future*. Foreign, 1996

Diplomacisë publike, që nënkupton komunikimin individual, të bazuar në një nivel të lartë besimi, duke krijuar marrëdhënie të ngushta.

Signitzer dhe Coombs e përkufizojnë diplomacinë publike si ‘një mënyrë me të cilën qeveria dhe individët dhe grupet private mund të ndikojnë drejtpërdrejtë ose indirekt në opinione dhe qëndrime publike, të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në vendimet e politikës së jashtme të një qeverie tjetër. Në kuptimin e tyre diplomacia publike po zgjeron fushën e saj të veprimtarive diplomatike tradicionale: nga sfera e ‘politikës së lartë’ për çështjet dhe aspektet e larmishme të jetës së përditshme dhe nga sfera ‘e mbyllur’ e qeverive dhe diplomatëve mbi aktorë të rinj dhe grupe të synuara, d.m.th individë, grupe dhe institucione të ndryshme, të cilat po bashkohen me aktivitete të komunikimit ndërkombëtar dhe ndërkulturor dhe kanë ndikim në marrëdhëniet politike midis vendeve arrin në përfundimin se qëllimi i diplomacisë publike është shpjegimi dhe të folurit në favor të politikës qeveritare dhe përfaqësimi i një kombi para publikut të huaj. Ai e përkufizon diplomacinë strategjike publike si ‘qeveri ndaj njerëzve’, veprimtari diplomatike, e cila përfshin përpjekjet e qeverisë për të ndikuar në opinionin publik dhe elitat në një vend tjetër dhe përmes kësaj edhe aktivitetet e politikës së jashtme të një vendi të synuar.¹⁸

Ky përkufizim novator është i rëndësishëm sepse njeh aktorë të rinj dhe heq dallimin midis diplomacisë publike dhe marrëdhënieve publike. Ripërcakton peisazhin e ndërkombëtarëve në marrëdhënie duke shtuar aktorë jostatik dhe duke pasqyruar ndërvarësinë në rritje midis të gjithë aktorëve.

Për të arritur objektivat lëndë e parë që i nevojiten diplomacisë publike janë kultura, vlerat kombëtare, politika e jashtme dhe e brendshme e një vendi. Si objektiva të diplomacisë publike mund të kemi:

- Realizimin e interesave kombëtare dhe mbrojtja e qëllimeve të politikës së jashtme kombëtare.
- Forcimi i ndikimit të synuar në audiencën e huaj, vendosja e një mirëkuptimi apo njohjeje më të madhe midis popujve.
- Formimi i opinioneve pozitive përballë audiencës së huaj, me qëllim realizimit të objektivave të politikës së jashtme e të brendshme të një shteti.
- Krijimi i kushteve të favorshme dhe arritja e mbështetjes nga opinioni publik i shteteve të tjera me veprime konkrete të shtetit të dhënë në arenën ndërkombëtare.

¹⁸ Signitzer, Benno H. and Coombs, Timothy , Public Relations and Public Diplomacy. Conceptual Convergences. Public Relations Review, 1992

- Ndërtimi i marrëdhënieve afatgjata dhe të besueshme me audiencën e huaj.
- Arritja e një njohjeje më të mirë të vlerave dhe instituteve të shtetit përkatës jashtë.
- Zgjerimi i dialogut ndërmjet qytetarëve të shtetit përkatës me partnerët e huaj.
- Përmirësimi i imazhit të vendit. Një rëndësi të veçantë kanë mjetet e realizimit praktik të qëllimeve të diplomacisë publike, ndër të cilët përmendim.
- Përvijimi i mesazhit që do të përcillet jashtë kufijve.
- Informimi i auditorëve të huaj, duke përfshirë grupe të veçanta dhe individë.
- Një pasqyrim/sqarim i argumentuar i politikës së jashtme dhe të brendshme të një shteti, përmes një dialogu të hapur.
- Analiza e mënyrës të interpretimit së ‘mesazhit’ të transmetuar në audiencat e huaja, studimi i tendencave të opinionit publik të huaj, etj.
- Ndikimi mbi ata që formojnë opinionin publik të huaj.
- Krijimi dhe zhvillimi i instrumenteve të komunikimit dhe bindje, kontaktet direkte midis instituteve publike, mjeteve të informimit publik, grupeve dhe individëve nga shtete të ndryshme.
- Shkëmbimi ndërkombëtar aktiv, krijimi i strukturave të sponsorizuara kulturore shtetërore, programeve arsimore dhe informuese.
- Tërheqja e studentëve në programet e shkëmbimit, organizimit të seminareve dhe takimeve me përfaqësues të shtetit, biznesit, komuniteteve kulturore dhe shkencore.
- Propaganda e vlerave të një shteti përmes kinematografisë, televizionit, radios, muzikës, sportit, videolojërave, teatrit, turizmit, komunikimit në internet.

Jospeh Nye si një hulumtues i diplomacisë publike dhe komunikimit, shpreh: ‘politika në epokën e informimit nuk është më çështje se cila ushtri është fituese, por se cila çështje është treguar më së miri.’

Kissinger përcakton se diplomacia është një metodë për të ndihmuar në mbrojtjen e interesave kombëtare përmes ndërveprimeve me shtetet e tjera¹⁹. Pra diplomacia publike mund dhe duhet të shihet si një shtrirje e këtyre funksioneve diplomatike duke bërë të mundur që shtetet të arrijnë aktorë jo-shtetërorë në vendet e huaja. Ky zhvillim domethënës në historinë e komunikimit njerëzor mund të ndikojë thellë në rrjedhën e punëve ndërkombëtare.

¹⁹ Berridge, G.R., Keens-Soper, Maurice, Otte, T.G, *Diplomat Theory from Machiavelli to Kissinger*, 2001




Tabela 2. Diplomacia Publike dhe Diplomacia Tradicionale, (Kevin Mulcahy dhe Harvey Feigenbaum)

Lloj i diplomacisë, që si term për herë të parë është përmendur në artikullin *The American president with a laudable desire* (Presidenti amerikan me dëshirë të lavdërueshme) të gazetës *Time* të datës 15 janar 1856. I pari e ka përkufizuar Geoff R. Berridge në veprën e tij *Diplomacia*, kurse kuptimin e sodit ia ka dhënë Edmund Gullion më 1965 duke i shqyrtuar reaksionet e publikut ndaj veprimeve politike dhe ushtarake të SHBA-së në Vietnam dhe Kongo. Diplomacia që synon përfitimin e zemrave dhe mendjeve të huaja (*winning foreign hearts and minds*), gjetjen e mbështetjes publike, që rëndësi u kushton deklaratave të qarta dhe publike, diplomacin *transparente* dhe gjerësisht e shpërndarë, e kundërta e diplomacisë së fshehtë, luftë psikologjike (Holbrook). Përpjekje të mbështetura nga qeveria për komunikim të drejtpërdrejtë me publikun e huaj me qëllim përkrahjen ose tolerimin e synimeve strategjike të saj. Diplomaci që ngërthen trinomin: identitet (gjendja aktuale e vendit), imazh (perceptimi i jashtëm) dhe komunikim (transformimi). Sipas Stanton H. Burnett-it, diplomacia publike nuk ka të bëjë me mënyrën e punës që një diplomat bën, por me publikun të cilit i drejtohet, nuk është e drejtuar kah diplomati i rangut të njëjtë në ministrinë e huaj, por kah publiku. Richard Ross thotë se është mënyrë për t'i bërë për vete popujt tjerë. Signitzer dhe Coombs këtë lloj të diplomacisë e perceptojnë si “mënyrë përmes të cilës qeveria dhe ndërmarrësit publikë, si edhe grupet, ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në qëndrimet ose opinionin e publikut, që më pas bëjnë trysni mbi vendimet e politikës së jashtme të një vendi tjetër.” Në vitet 1950 ky term ka zëvendësuar shprehjet informim ndërkombëtar dhe propagandë. Shtetet e Bashkuara nga viti 1917 kanë Komitetin për Informim Publik, kurse nga 1999-a, Nënsekretar të Shtetit për Diplomaci dhe Punë Publike (Under Secretary of State for Public Diplomacy and Public Affairs). Edhe organizatat mbishtetërore kanë makinerinë e tyre të diplomacisë publike: Stefanie Babst nga zyra e sekretarit kryesor për diplomaci publike pranë NATO-s, pohon se ky subjekt përkundër

konkurrencës me miliona porosi të tjera ende gëzon mbështetje në opinionin publik të Europës dhe të SHBA. Në Europë varianti gjerman i diplomacisë publike shfaqet si *politische Öffentlichkeitsarbeit* (lidhje politike me publikun), ai francez si *politique d'influence*, kurse Holanda ka filluar ta profesionalizojë si *publieksdiplomatie*. Izraeli që nga vitet 1970 ka *hasbara*-në që shenjon teknikat për përhapje të informatave pozitive tek bashkësia ndërkombëtare, strategjinë ‘qeveria për njerëzit’ (G2P) dhe ‘njerëzit për njerëzit’ (P2P). Turqia e ka shfrytëzuar këtë vegël në ish-republikat sovjetike dhe në vendet e Azisë së Mesme. Kjo diplomaci përfshin prezencën në mediat tradicionale, ngjarjet kulturore, konferencat, ligjëratat që e afirmojnë një shtet në vendet tjera, aktivitetet sportive, turizmin, operacionet psikologjike ushtarake, diplomacinë qytetare, kulturore, por edhe fuqinë e butë (*soft power*), që disa e ndërlidhin me diplomacinë e re publike (*new public diplomacy*), shfrytëzimin e blogjeve, të podcasteve, të facebookut, twitterit, porosive të celularit, lojërat e kompjuterit, spin doktorët ose “drejtuesit e perceptimit” e të ngjashme. Rol në diplomacinë publike kanë edhe OJF-të, mediat globale (CNN, BBC, Al-Jazeera, CCTV, France 24, Russia Today, TRT), industria filmike (e Hollywoodit, Bollywoodit, ajo turke e serialeve), agjencionet si USAID-i amerikan, TIKA, qendrat dhe institutet kulturore (“Këndi amerikan”, British Council, Instituti “Goethe”, Qendra Kulturore Franceze, “Junus Emre”), programet e shkëmbimit (Erasmus +, ASSE, NSE, ISEP, “The International Visitor Leadership Program” (IVLP), “Congress-Bundestag Youth Exchange” [CBYX]) etj. Pas Luftës së Dytë Botërore në SHBA në sajë të programeve për shkëmbime kulturore dhe akademike janë shkolluar rreth 700,000 veta, në mesin e tyre edhe liderët botërore si Enver Sadat, Helmut Schmidt, Margareth Thatcher. Sipas Joseph Nye Jr. diplomacia publike ka tre përmasa: (1) komunikimi dhe informimi në baza ditore, (2) planifikimi strategjik dhe “markëzimi” (brendimi) i një shteti, dhe (3) krijimi i lidhjeve dhe institucionalizmi afatgjatë. Sipas Kugelmanit, për të qenë i suksesshëm në këtë lëmë duhet pasur tre cilësi: inkluzivitetin, sinqeritetin dhe respektin ndaj identitetit dhe vlerave të kombit tjetër. Diplomacia publike shqiptare është kryesisht e përqendruar te opinionin publik i vendeve anëtare të BE-së (p.sh. slogani kosovar “Young Europeans”). Ndër ‘aktorët’ më me ndikim të saj janë Ismail Kadare, Majlinda Kelmendi, Dua Lipa etj.²⁰

²⁰ Dağ, Ahmet E, Pajaziti, Ali, Fjalor i Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe i Diplomacisë, Shkup, Prishtinë, Tirane, 2019

2.2.Komunikimi global

Nevoja për komunikim buron në çdo projekt apo qëllim. Pra në thelb ekziston në pritje nga një grup për ndryshim të politikave ose një strukturë. Nevoja për komunikim është shfaqur për shkak të rritjes së globalizimit dhe ndikimeve që ato kanë, prandaj dhe si fushë studimi komunikimi është një urë që bën lidhje ndërvepruese ndërmjet shteteve, bizneseve dhe njerëzve. Ajo që ne e quajmë ‘komunitet’ dikur ishte e kufizuar në dialogun ballë për ballë midis njerëzve në të njëjtën hapësirë fizike, një dialog që pasqyronte shqetësime reciproke dhe një kulturë të përbashkët. Sot, as bashkësia dhe as dialogu nuk kufizohen në një vend gjeografik. Media moderne ka zgjeruar ndjenjën tonë për vendin duke rialokuar hapësirën dhe kohën. Në të kaluarën, marrëdhëniet personale mbështeteshin në takimin në një kafene, nënshkrimin e një kontrate së bashku, shtrëngimin e duarve ose bashkëveprimin në sheshin e fshatit. Me ardhjen e aparatit të faksit, telefonat, botimet ndërkombëtare dhe kompjuterët, marrëdhëniet personale dhe profesionale mund të mirëmbahen pavarësisht nga koha dhe vendi. Sot ne madje mund të flasim për shoqërinë civile globale, atë pjesë të jetës sonë që nuk është as treg, as qeveri, por që përmblyen prej tyre. Para se teknologjitë e kalimit kufitar të përhapen, shoqëritë e ndryshme civile të globit kishin vështirësi të bashkoheshin në aleanca më të gjëra. Sot teknologjitë e reja nxisin komunikimin midis shumëllojshmërisë më të gjerë të organizatave joqeveritare dhe jofitimprurëse të planetit në fushat e të drejtave të njeriut, mbrojtjen e konsumatorit, paqen, barazinë gjinore, drejtësinë raciale dhe mbrojtjen e mjedisit. Komunikimi ndërkombëtar si një fenomen është ndoshta i vjetër sa vetë shoqëria njerëzore dhe ka ndodhur që kur njerëzit u organizuan në bashkësi dhe filluan të shkëmbejnë ide dhe produkte.²¹ Sidoqoftë, fenomeni i komunikimit global siç e dimë sot është në thelb rezultat i përparimeve teknologjike. Ndoshta filloi me zhvillimin e teknologjisë së përparuar të transportit, siç është motori me avull dhe motori i djegies së brendshme.²² Aktualisht ajo është e udhëhequr nga përhapja në mbarë botën e teknologjive të përparuara të informacionit dhe komunikimit

Poashtu luan një rol të rëndësishëm pasi që nga lashtësia, komunikimi profesional është përdorur si indikator për komunikim efektiv të përvojave njerëzore, duke marrë parasysh këtu mënyrën e sjelljes, shkëmbimit dhe interpretimit të mesazheve. Në periudhën e sotme komunikimi përdor disa strategji, teori dhe teknologji për një komunikim sa më efektiv të botës biznesore.

²¹ Mowlana, H. , Global communication in transition: the end of diversity? Thousand Oaks, CA: Sage, 1996

²² Frederick, H.H., Global communication & international relations. Belmont, CA: Wadsworth, 1993

Politikisht, komunikimi global merr përkufizimin si dëmtues i kufijve dhe sovranitetit tradicional të kombeve. Prandaj dhe misioni i komunikimit global është të përgatisë partnerë për ndryshime. Në thelb duhet të ndiqen disa rregulla të cilat janë në përputhje me vendin pritës, krijimi i një komunikimi efektiv ndërkulturor, negocimi në kontekst të komunikimit ndërkulturor dhe komunikim diskret.

Duke pasur parasysh dhe duke u bazuar në kontekstin historik, kanalet e komunikimit kanë luajtur role të rëndësishme në përkeqësimin e tenseve. Bota e komunikimit sot shfaqet me pasiguri, lëvizje të fuqishme, sulme terroriste dhe gjuhë të urrejtjes. Shpërndarja e shpejtë e informacionit nga mjetet teknologjike nga njëra anë e globit në anën tjetër, vendet, institucionet dhe shoqëria përballen me realitete që sjellin pasoja në aspektin negativ, por duke u parë në aspektin pozitiv gjithashtu mund të sjellin promovim të paqes, të krijojë besim midis shoqërive, kombeve dhe popujve dhe të forcojë mirëkuptimin.

Rritja e demokracisë dhe arritja e pavarësisë nga shumë ish koloni të fuqive të mëdha evropiane gjithashtu çoi në një rritje të numrit të shteteve të kombeve që morën pjesë në aspektet politike, kulturore dhe socio-ekonomike të komunikimit ndërkombëtar. Gjatë kësaj periudhe SH.B.A. u shfaq si fuqi politike mbizotëruese dhe punësoi gjithnjë e më shumë media, jo vetëm për qëllime të sundimit ekonomik dhe ushtarak, por edhe kulturor. Me rëndësi të veçantë ishte periudha e Luftës së Ftohtë që shërbeu edhe një herë për të theksuar rëndësinë e komunikimit politik ndërkombëtar siç është propaganda. Organizatat politike dhe kulturore ndërkombëtare si Kombet e Bashkuara (KB) dhe Organizata Shkencore dhe Kulturore Arsimore e Kombeve të Bashkuara (UNESCO) kontribuan më tej në debate ndërkombëtare për çështje të komunikimit, ndërsa lëvizjet revolucionare nëpër botë mobilizuan rrjetet globale të komunikimit për të arritur qëllimet e tyre.

Komunikimet globale jo vetëm që po sfidojnë legjitimitetin, sovranitetin dhe autoritetin e shtetit komb, por gjithashtu kanë implikime të gjera për komunikimin ndërkombëtar: zhvendosjen e paradigmave, teorive dhe fokuseve të interesit.²³ Kufijtë e shteteve të kombeve janë bërë poroze pasi globalizimi i teknologjisë e ka bërë praktikisht të pamundur për qeveritë që të rregullojnë dhe kontrollojnë rrjedhën ndërkufitare të informacionit dhe komunikimit. Në këtë mënyrë komunikimi global po dëmton gjithnjë e më shumë autoritetin dhe legjitimitetin e shteteve të kombeve.

Komunikimi global po fuqizon gjithashtu grupe dhe zëra të marginalizuar dhe shpesh të harruar në bashkësinë ndërkombëtare, i cili më tej paraqet një sfidë për autoritetin e

²³ Bornman, E. , Struggles of identity in the age of globalisation, 2003

shteteve të kombit brenda kufijve të të cilëve ata jetojnë. Shumë forma interaktive të komunikimit global kanë krijuar gjithashtu hapësira të mëdha morale për të eksploruar bashkësi të reja ose alternative të afrimitetit dhe identitetit.

2.2.1 Rrjedha e lirë e informacionit

Vlen të përmendet dhe 'rrjedhja e lirë e informacionit' e cila u shfaq gjatë Luftës së Ftohtë, kur bashkësia ndërkombëtare u karakterizua nga ndarja bipolare midis kapitalizmit dhe socializmit.²⁴ Në debatet fillestare mbi komunikimin ndërkombëtar, parimi i rrjedhës së lirë shoqërohej, nga njëra anë me antipatinë e liberalizmit dhe kapitalizmit perëndimor ndaj rregullimit shtetëror dhe censurimit të mediave dhe kërkesat e tyre për një rrjedhë të pakufizuar të informacionit²⁵. Marksistët, nga ana tjetër, argumentuan për rregullime më të mëdha shtetërore për të kontrolluar rrjedhën e lajmeve dhe transmetimit të materialeve në shoqëritë e tyre.

Diskursi i 'rrjedhës së lirë të informacionit' është ngulitur thellësisht në diskutimet mbi demokracinë.²⁶ Në një demokraci, roli i mediave masive besohet të jetë që të informojë elektoratin për çështje publike, të zgjerojë bazën e pjesëmarrjes në procesin politik dhe të vëzhgojë sjelljet e qeverisë. Përkrahësit e një rrjedhe të lirë informacioni bazohen në argumentet e tyre mbi ligjërimin liberal të të drejtave të individëve për lirinë e idesë dhe shprehjes. Sistemet e lirisë së shprehjes dhe informacionit vlerësohen si parimet kryesore të demokracisë dhe parakushtet për media për të promovuar demokracinë.

Gjatë viteve 1940 dhe 1950 parimet e 'tregut të lirë të ideve' dhe 'rrjedhës së lirë të informacionit' jo vetëm që u bënë përbërës thelbësorë të politikës së jashtme amerikane, por u miratuan edhe në Kartën e Kombeve të Bashkuara, Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut dhe deklarata të tjera të lidhura me UNESCO-n. Sidoqoftë, ndërsa debatet e rrjedhës së lirë ishin kryesisht një çështje Lindje-Perëndim në periudhën menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, vitet 1960 panë një ndryshim në strukturat globale të energjisë, pasi shtetet e reja të pavarura afrikane dhe aziatike hynë në debate mbi komunikimin ndërkombëtar. Pabarazitë në rrjedhën e komunikimit dhe informacionit për më tepër besohet se paraqesin kërcënime për pavarësinë e tyre politike dhe sovranitetin kombëtar, vlerat kulturore dhe zhvillimin

²⁴ Ayish, M., From "Many voices, one world" to "Many worlds, one voice": reflections on international communication realities in the age of globalisation. JAVNOST – THE PUBLIC, 2005

²⁵ Thussu, D.K. International communication: continuity and change. London: Arnold, 2000

²⁶ Ayish, I., International communication in the 1900s: implications for the Third World. International Affairs, 2001

⁶⁰ Buhmann, A., Ingenhoff, D., The 4D-model of the country image. An integrative approach from the perspective of communication management. International Communication Gazette, 2015, f. 102-124.

është një kusht i domosdoshëm për t'u përfshirë në diplomaci publike⁶¹. Szondi identifikoi tre faza të ndryshme në evolucionin e diplomacisë publike amerikane: Periudha e parë shtrihet gjatë katër dekadave kur vlerat dhe normat amerikane dhe perëndimore u përhapën intensivisht në të gjithë Evropën Lindore dhe një gamë e tërë metodash u përdorën për të bindur njerëzit që linin pas hekurit perde. Rënia e Murit të Berlinit shënon fazën e dytë të diplomacisë publike, kur dukshëm më pak përpjekje dhe burime iu kushtuan diplomacisë publike që rezultoi në rënien e diplomacisë publike amerikane në të gjithë botën. Shkatërrimi dhe shembja tragjike e Qendrës Botërore të Tregtisë më 11 Shtator 2001, shënon fillimin e fazës së tretë.

Ai argumentoi se qëllimet, strategjitë, kushtet, udhëzimet e komunikimit dhe mesazhet duhet të ndryshojnë në një kontekst global. Diplomacia publike e shekullit XXI nuk duhet të evoluojë përmes konflikteve apo tensioneve mes shteteve, dhe nuk duhet të bazohet në bindje për të menaxhuar publikun, por duhet të përparojë në kohë paqeje dhe të drejtohet për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e marrëdhënieve duke u angazhuar me publikun përmes dialogut.

Edhe pse jo shumë shtete kanë mundësinë e financimit për të sjellë diplomacinë publike, shtetet e 'Botës së Tretë' kanë marrë hapa për tu kyçur në marrëdhënie ndërkombëtare publike të nivelit të autoriteteve qeveritare të huaja. Këtu diplomacia publike është e lidhur përmes marrëdhënieve publike të nivelit qeveritar, ku agjensitë e brendit dhe marketingut këshillojnë qeveritë në lidhje me imazhin e vendit, ato zhvillojnë idetë dhe elementet për të prodhuar një brend kombëtar⁶², ku imazhi i vendit varet nga ajo çka aprovon qeveria dhe gjithçka zhvillohet në nivel qeveritar dhe jo jashtë saj.

Përkundër kësaj vendet Perëndimore arrijnë deri te publiku i huaj duke përdorur diplomacinë publike si mjet për promovimin e demokracisë, për zgjerimin e mënyrave veprimeve të ndërmarra dhe për të folur kundrejt instrumenteve politike. Kurse vendet të cilat janë në ndjekje të mbijetesës ekonomike, përdorin marrëdhëniet ndërkombëtare për t'u drejtuar drejtpërdrejt autoriteteve të qeverisë së huaj, jo qytetarëve të vendeve të huaja.

Shtete e mëdha shpesh janë hasur me sfida dhe ballafaqime të ndryshme në menaxhim të imazhit të vendit të tyre kundrejt publikut të huaj. Prandaj dhe ato përdorin strategji të shumta të cilat në mënyrë direkte arrijnë deri tek publiku i huaj përmes strukturave qeveritare. Ato përdorin gjithashtu organizata joqeveritare për ti përfaqësuar duke kontribuar pozitivisht

⁶¹ Szondi, G, Public diplomacy and nation branding: Conceptual similarities and differences. The Hague, 2008
<https://www.clingendael.org/publication/public-diplomacy-and-nation-branding-conceptual-similarities-and-differences>

⁶² Po aty 97

në imazhin e shtetit përmes aktiviteteve dhe kanaleve të ndryshme të cilat arrijnë deri tek shoqëria civile.

Ajo çka duan të arrijnë vendet Perëndimore për publikun e huaj është sigurimi i interesit të tyre, dhe ato gjithmonë janë të prirur për të përdorur dialogun duke ndjekur zhvillimet aktuale të globalizimit dhe botës politike. Kurse shtetet tjera më pak të zhvilluara diplomacia publike zhvillohet në nivel qeveritar, dhe jo me publikun. Pra ato fokusohen duke punuar në mënyrë direkte me qeveritë e huaja dhe jo me publikun. Arsytet janë të shumta që një qasje e tillë zhvillohet, dhe këto indentifikojnë nevojën për mbijetesë ekonomike në një vend ku besueshmëria e tyre për publikun e huaj zhvillohet në atë nivel.

Sipas Kunczik ‘imazhet e kombeve kanë një ndikim të fortë në rrjedhën e kapitalit ndërkombëtar’⁶³. E kështu për vendet më pak të zhvilluara, ekzistenca e kriterëve të caktuar për pranueshmërinë për të marrë ndihmë në formë kredie nga institucionet monetare ndërkombëtare i ka detyruar ata të krijojnë një imazh që mund t’ju besohet për të arritur në vendet e zhvilluara. Mungesa e burimeve njerëzore dhe financiare mund të kufizojë diplomacinë publike për vendet në zhvillim. Krijimi i imazhit të vendeve në zhvillim do të varet kryesisht nga marrëdhëniet me publikun ndërkombëtar pasi i ndihmon ata në mënyrë adekuate të përcjellin një imazh të mirë për qeveritë e vendeve perëndimore.

Prioritetet e diplomacisë publike mund të zhvendosen shkakut i prosperitetit ekonomik. Kina si një shtet i zhvilluar ka arritur të dëshmojë drejtime të reja në diplomacinë publike, ku diplomacia kineze kishte për qëllim të vendos bashkëpunim bilateral dhe multilateral në nivel të qeverisë. Por me rritjen e fuqisë ekonomike nxiti vendin për të menduar në aspektin e pushtetit të butë⁶⁴. Jay Wang shprehet se diplomacia publike kineze ndryshoj strategjitë e saj duke u bazuar në dy role: së pari diplomacia publike duhet të jetë një kanal për mendime të nivelit të lartë strategjik dhe arsye mbrojtëse, dhe së dyti si një detyrë për të lehtësuar ngritjen e Kinës në pushtet të butë.

Vendet më pak të zhvilluara janë më të shqetësuara për kredibilitetin dhe besimin ndaj qeverive të huaja, sesa të arrijnë në publikun e tyre. Megjithatë, ekzistojnë disa objektiva themelore që kërkojnë kryesisht një bashkëveprim në nivelin qeveritar. Objektivat kryesore kanë të bëjnë me ruajtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial të një kombi dhe zhvillimin ekonomik. Këto synime janë realizuar përmes ‘diplomacisë standarde ose tradicionale, si një

⁶³ Kunczik, M., Transnational public relations by foreign governments. In K. Sriramesh & D. Vercic (Eds.), Handbook of global public relations, 2008, f 399-424

⁶⁴ Wang, Y., Public diplomacy and the rise of Chinese soft power. The Annals of the American Academy of Political and Social Sciences, 2008, f. 257-273.

art tradicional të negociatave, përfaqësimit dhe analizave'.⁶⁵

Komunikimi dhe informacioni janë thelbësore për përpjekjet bashkëpunuese në të gjithë botën dhe shpesh luajnë role vendimtare në krijimin e kushteve për paqen, dinjitetin njerëzor, drejtësinë dhe zgjidhjen e problemeve. Studiuesi Nye paraqet strategjitë komunikuese përmes tre dimensioneve⁶⁶: për “komunikimin e përditshëm dhe informativ” është e rëndësishme që informacioni të jetë i saktë, perceptues dhe i qëndrueshëm, pasi që këto i japin domethënie efikasitetit të mesazhit për të tërhequr opinionin e publik. Kurse “plani strategjik dhe brendi nacional” bazohet në strategjitë dhe planifikimin afatgjatë, dhe mesazhet mund të jenë më efektive nëse shteti ka reputacion dhe kredibilitet. Dhe dimension i fundit “ndërtimi i marrëdhënieve të mira dhe zhvillimi i tyre” vë në pah suksesin e qëndrueshëm. Marrëdhëniet e mira me vendet e synuara dhe shoqërinë duhet të jenë të themeluara përmes metodave dhe mjeteve të diplomacisë publike. Mjetet veçanërisht siç janë aktivitetet arsimore, programet e shkëmbimit dhe trajnimet praktike krijojnë mundësi të konsiderueshme për krijimin e marrëdhënieve të përhershme dhe afatgjata. Këto marrëdhënie mundësojnë që vendet të afrohen, në mënyrë që të mund ta kuptojnë dhe bindin gjithnjë e më shumë njëri-tjetrin.⁶⁷

Shumë qeveri po bëjnë presion që "Ministritë e Punëve të Jashtme të Shekullit XXI" të përshtaten me këtë mjedis në zhvillim. Për më tepër, Ministritë e Punëve të Jashtme (MPJ) zhvillojnë aktivitete për qasje publike të ngjashme me ato jashtë vendit, por të drejtuara nga një audiencë vendase, dhe ata bashkëpunojnë me qytetarët vendas në kryerjen e programeve të diplomacisë publike (siç janë shkëmbimet), por ato jo domosdoshmërisht mund t'i pranojnë ato si pjesë e konceptit të diplomacisë publike. Investimi në diplomacinë publike është një alternativë jetike edhe pse më pak e drejtpërdrejtë për misionet e tyre për të ndikuar në përfaqësuesit e tyre qeveritar jashtë vendit.

Deklarata teorike në favor të një “diplomacie publike të re ose Shekullit XXI”⁶⁸ ka theksuar më tepër nevojën për të ripunuar më shumë pikëpamje tradicionale të komponentëve thelbësorë të diplomacisë publike në reagim ndaj një mjedisi në zhvillim. Mund të vërehen interpretimet në ndryshim të qëllimeve të diplomacisë publike (nga hartimi i mesazheve

⁶⁵ Ur Rashid, B, Third world diplomacy. The Daily Star Internet. 2007

⁶⁶ Nye, S.J. , Soft Power: The Means to Success in World Politics. New York: Public Affairs, 2005

⁶⁷ Özkan, A. “ Yüzyılım etkili iletisim yöntemi kamu diplomasisinde yumusak güç unsuru olarak medyanin stratejik kullanımı”, International Communication Science and Media Studies Congress, Kocaeli University Faculty of Communication:Kocaeli, 2014

⁶⁸ Brian Hocking, “Rethinking the ‘New’ Public Diplomacy” and Shaun Riordan, “Dialogue-Based Public Diplomacy: A New Foreign Policy Paradigm,” in the New Public Diplomacy, 2009

statike dhe shpërndarja në shkëmbimin dhe ndërveprimin dinamik të rrjetit), aktorët (nga shtetet te aktorët e shumtë), publiku (nga drejtuesit e opinionit pasiv dhe ndërkombëtar deri tek audienca aktive, vendase dhe ndërkombëtare dhe publiku në përgjithësi), lidhjet e tyre (nga të dallueshme në të lidhura), kulturën (nga pengesat kulturore midis ‘atyre’ dhe ‘neve’ deri tek përfshirja e diversitetit kulturor), dhe mjetet (nga shpërndarja e informacionit tek aktiviteti i ndërtimit të marrëdhënieve).⁶⁹ Në thelb, mbështetësit e një imazhi bashkëkohor të diplomacisë publike argumentojnë për rishfaqjen e ‘rrjetit publik’ mbi ‘komunikimin qeveritar’. Ata preferojnë ‘qeverisjen’ mbi ‘qeveritë’ dhe ‘rrjetëzimin’ mbi ‘informimin’.⁷⁰ Ky është konteksti në të cilin duhet të kuptohen evolucionet dhe qëndrimi ndaj dimensionit të brendshëm të diplomacisë publike.

Studiues të shumtë bazohen në dy terma që janë shoqëruar me dimensione të brendshme të diplomacisë publike si çështjet publike dhe shtrirja e brendshme. Mirëpo studiuesi Nicholas Cull e paraqet diplomacinë publike si komponent esencial të politikave të jashtme dhe mbështet gjashtë qasje të cilat ai i paraqet si thelbësore për publikun e huaj.

- Sipas tij diplomacia publike⁷¹ fillon me ‘të dëgjuarit’, edhe pse për shumë qeveri diplomacia publike është të flasin, mbledhjen dhe analizimin sistematik të opinionëve të publikut të huaj. Për më tepër, lidhja më e rëndësishme në çdo strukturë të diplomacisë publike është ajo që lidh dëgjimin me hartimin e politikave dhe siguron që opinioni i huaj të peshohet në procesin e politikës së jashtme. Teknologjia e re sot e bën më të lehtë dëgjimin për diplomatët publik. Çdo informacion ose çështje monitorohet dhe përçohet në kohë reale në mbarë botën, prandaj dhe nevoja për tu parë dhe dëgjuar qëndron e pandryshuar.
- Si element tjetër themelor është ‘avokimi’ që nënkupton prezantimin e drejtpërdrejtë të politikave dhe informacionit. Në diplomacinë publike avokimi përkufizohet si një përpjekje nga një aktor vendas për të menaxhuar mjedisin ndërkombëtar duke ndërmarrë një veprimtari të komunikimit ndërkombëtarë për të promovuar në mënyrë aktive një politikë, ide të veçantë ose interesant e përgjithshme të aktorit në publikun e huaj. Të dëgjuarit dhe avokimi janë të besueshëm kur perceptohen si burim i afërt i politikës së jashtme dhe kështu janë në gjendje të futen në politikë ose të flasin për të me një autoritet të vërtetë.

⁶⁹ Kathy R. Fitzpatrick, “U.S. Public Diplomacy in a Post-9/11 World: From Messaging to Mutuality,” paper presented at ISA Conference, 2011,

⁷⁰ Huijgh, Ellen, “Public Diplomacy of Federated Entities”, 2010

⁷¹ Cull, J. Nicholas, Public Diplomacy: Lessons from the Past, 2009

- Si faktor tjetër në diplomacinë publike të Culls është '*diplomacia kulturore*' e cila nënkupton lehtësimin e eksportit ose pjesëmarrjen në kulturë. Aktorët e diplomacisë kulturore tërheqin besueshmërinë nga integriteti, duke përfshirë shkëmbimin e ideve dhe informacionit nëpërmjet gjuhës së artit dhe aspekte të tjera kulturore, e cila ndihmon kombeve dhe opinionit të njerëzve për të ndërtuar marrëdhënie të mira⁷².
- '*Diplomacia shkëmbyese*' bazohet në shkëmbimin e ndërsjellë të qytetarëve, veçanërisht studentëve me një partner të huaj. Ideja është që të krijohet një rrjet njerëzish me ndikim jashtë vendit që do t'i lidhin ata me vendin e tyre pritës dhe do ta vlerësojnë vendin e tyre për atë kohë që ato janë duke kaluar në atë vend.
- Dhe si një element të fundit numëron '*transmetuesit ndërkombëtarë*' duke përdorur radion, televizionin dhe internetin, për të tërhequr publikun e huaj përmes transmetimit të drejtpërdrejtë të lajmeve.

Duke u bazuar në këto elemente të Diplomacisë publike e gjithë struktura e Diplomacisë Publike funksionon me politikat, kulturën dhe vlerat e shoqërisë që e drejton atë, faktorët që studiuesi Nye i emëron fuqia e butë e një aktori. Këta faktorë të fuqisë së butë duhet të merren parasysh gjithashtu në çdo vlerësim të diplomacisë publike të një aktori, duke pasur parasysh strukturat më të mira të diplomacisë publike në botë të cilat jo vetëm mund të bëjnë politika të mira, por gjithashtu mund të ushqejnë opinionin ndërkombëtarë në procesin e politikave dhe të bëjë politika akoma dhe më të mira.

Diplomacia vazhdimisht është adaptuar në ndryshimin e sistemeve ndërkombëtare, në shtete dhe shoqëri. Për dekada të tëra ministri të jashtme dhe veprime qeveritare janë fokusuar në projektimin e imazheve kombëtare për qëllime të ndryshme. Rritja e ekonomisë dhe integrimi i shoqërisë ka rritur nevojën për të projektuar një brend kombëtar në mjedis konkurrues global. Por krahas kësaj shfaqet një perspektivë tjetër për diplomacinë publike e cila e shikon atë në drejtim të një mënyre tjetër të politikës ndërkombëtare. Sa i përket organizimit të funksionit të diplomacisë publike, informacionet politike zakonisht gjenden në një seksion politik të Ministrisë së Jashtme, domethënë afër aparatit të lartë politikëbërës, ose me sekretarin politik të një ambasade; komunikimi kulturor, në të kundërt, është disi i mbrojtur nga presionet e përditshme të politikës së jashtme dhe zakonisht i besohet një seksioni kulturor të ministrisë së jashtme ose një ambasade (ose një seksioni ndërkombëtar të

⁷² "Cultural Diplomacy, Political Influence, and Integrated Strategy," in Strategic Influence: Public Diplomacy, Counterpropaganda, and Political Warfare, ed. Michael J. Waller, Washington, DC: Institute of World Politics Press, 2009

një ministrie të arsimit ose kulturës), një instituti kulturor jashtë vendit, ose një lloj organi gjysmë autonom, siç është Këshilli Britanik ose Instituti Gjerman Goethe⁷³.

Në ditët e sodit, institucionet shumëpalëshe po rrisin përdorimin e diplomacisë publike dhe mjete tjera komunikuese për të promovuar mirëkuptim dhe marrëdhënie të qëndrueshme me audiencën. Në 2004, Komisioni për Diplomaci Publike u krijua sipas Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), duke pasuar Komisionin për Informacion dhe Marrëdhënie Kulturore, e cila reflektonte rëndësinë e dhënë të informacionit dhe rritjen e ndërgjegjësimit nga anëtarët themelues të NATO-s. Delegacioni i Bashkimit Evropian në SHBA themeloi seksionin e shtypit dhe Diplomacisë Publike për të rritur ndërgjegjësimin për politikën e BE-së në Shtetet e Bashkuara. Me lëshimin e statutit të tij të parë në 2008, Shoqata e Kombeve të Azisë Juglindore (ASEAN) deklaroi se organizata do të praktikojë më shumë diplomaci publike, ose siç drejtuesit e saj iu referuan asaj: 'diplomacia e popullit'⁷⁴.

Qëllimi i diplomacisë publike për organizatat ndërkombëtare është të sigurojë një perceptim pozitiv të aktiviteteve të tyre midis formuesve të opinionëve, mediave dhe anëtarëve të publikut, të cilët do të mbështesin rrjedhimisht përfshirjen e vazhdueshme të qeverive të tyre në aktivitetet e organizatës. Kjo do të përfshijë bindjen e audiencës së tyre se aktivitetet që ndërmarrin janë relevante dhe japin përfundime. Diplomacia publike ka një rol të rëndësishëm në organizatat ndërkombëtare, pasi që shfaq fuqinë alternative, për qasje në krijim shtet. Një gamë e madhe e qeverisjes së mirë, edukimit, trajnimeve dhe promovimit të programeve ekonomike luajnë një rol mjaft domethënës duke sjellë vendet në prag të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Në shtetet ku intervenimi ka qënë më i vështirë dhe shoqëria civile ka qënë më pak aktive për pjesëmarrje, organizatat ndërkombëtare e kanë pasur më të vështirë, siç është rasi i Kosovës dhe Bosnja Hercegovinës. Pa kaluar në një kritikë të detajuar të përpjekjeve perëndimore për ndërtimin e kombit në vende të cilat synojnë Bashkimin Evropian, pjesë e problemit kanë qënë dështimi i demokracisë, respektimi i të drejtave të njeriut dhe ekonomia e dobët të cilat dalin nga kushtet sociale dhe kulturore.

Qeveritë dhe diplomatët kanë humbur në mënyrë progresive monopolin mbi marrëdhëniet ndërkombëtare. Përfshirja e organizatave ndërkombëtare në diplomacinë publike nuk është vetëm pranimi i zhvillimeve për marrëdhënie të mira ndërkombëtare, por lidhet me

⁷³ Mitchell, J. M, *International cultural relations*. London: Allen & Unwin, 1986

⁷⁴ Chachavalpongpun, P., "Digital Diplomacy in Southeast Asia," in *Rethinking Diplomacy: New Approaches and Domestic Challenges in East Asia and the European Union*, ed. Colin Duerkop Lam Peng Er, 2011

mënyrat efektive për zhvillim dhe implementim të strategjive.

Mjedisi diplomatik i shekullit XXI po ndryshon për shkak të zgjerimit të numrit dhe shumëllojshmërisë së aktorëve ndërkombëtarë, zhvillimit të agjendave të reja ndërkombëtare të sigurisë dhe ringjalljes së agjendave të vjetra politike⁷⁵. Dhe kjo diplomaci e re do të kishte formën e një ‘diplomacie integruese’ të një larmie aktorësh, e karakterizuar nga rritja e rrjeteve të politikave ndërkombëtare.

Aktorët e rinj të diplomacisë si OJQ-të, udhëheqësit fetarë, intelgjencat shtetërore, të famshmit dhe sektorët privat paraqesin supremaci shtetërore në botën diplomatike. Pasi që paraqiten si sipërmarrës, njohës dhe përfaqësues jozyrtarë ata kanë aftësi për të naviguar midis botës zyrtare dhe jozyrtare, të krijojnë koalicione përtej kufijve dhe të veprojnë kur qeveritë dështojnë të veprojnë⁷⁶. Një shembull konkret është Agjencioni për Zhvillim Ndërkombëtar i Shteteve të Bashkuara (USAID) të cilët mbështesin angazhimin e sektorit privat në Maqedoninë e Veriut, nxitje për unitet social, ndërgjegjësim të qytetarëve-përgjegjësi qytetare, avancim të ndërmarrjeve që për të arritur këtë, USAID ndihmon qeverinë e Maqedonisë së Veriut të përafrojë legjislacionin kombëtar me kërkesat e BE-së dhe Komunitetit të energjisë dhe të respektojë Direktivën e BE për Eficiencën e Energjisë. Poashtu dhe Korpusi i Paqes në Maqedoninë e Veriut (Peace Corps) e cila përmes vullnetarizmit punon me komunitetet e Maqedonisë së Veriut në projekte për arsim dhe zhvillim ekonomic të komuniteteve. Gjatë peirudhës së shërbimit në Maqedoninë e Veriut, Vullnetarët mësojnë të flasin gjuhë lokale, përfshirë gjuhën shqipe dhe maqedonase.

Diplomacia publike përfshin individë, grupe dhe institucione të ndryshme të cilët përmes komunikimit ndërkombëtar dhe ndërkulturor kanë ndikim në marrëdhëniet politike mes dy ose më shume vendeve. Dhe pjesëmarrësit e mediave, korporatave shumëkombëshe, OJQ-të dhe organizatat me bazë besimi, janë aktorë të rinj aktivë të cilët veprojnë tradicionalisht në veprimet e qeverive⁷⁷. Dhe këto aktorë kanë një avantazh të madh në adresimin e sfidave të diplomacisë publike dhe plotësojnë ndjeshëm përpjekjet e diplomacisë publike të qeverive të tyre përkatëse.

Për shkak të ndikimit të tyre në aktorët e shtetit, burimet ekonomike dhe teknologjike, strategjitë dhe instrumentet e angazhimit, aktorët jo-shtetërorë mbeten si palë të rëndësishme të diplomacisë publike. Korporatat shumëkombëshe, grupet e industrisë dhe OJQ-të janë në

⁷⁵ Brian Hocking; Jan Melissen; Shaun Riordan; Paul Sharp, “Futures for diplomacy: Integrative Diplomacy in the 21st Century,” (Netherlands Institute of International Relations “Clingendael,” 2012

⁷⁶ John Robert Kelley, “The New Diplomacy: Evolution of a Revolution,” Diplomacy & Statecraft, 2010

⁷⁷ Signitzer, B., Coombs, T., “Public Relations and Public Diplomacy: Conceptual Convergence,” Public Relations Review, 1992

gjendje të ndikojnë tek politikë-bërësit dhe diplomatët, dhe të përfshihen në dialog me qeveritë dhe publikun. Për më tepër, aktorët jo-shtetërorë janë partnerë kryesorë për zbatimin e programeve të diplomacisë publike. Sidoqoftë, disa nga këta aktorë jo shtetërorë promovojnë idealet e tyre dhe ndjekin interesat e tyre, veçanërisht korporatat shumëkombëshe që duan të avancojnë agjendën e tyre, të zbusin rregulloret, të ndryshojnë politikat dhe të formojnë qëndrime midis politikëbërësve, ndërsa OJQ-të përpiqen të fitojnë më shumë mbështetës për shkaqet dhe donatorët, të përforcojnë rregulloret dhe të ndryshojnë qëndrimet mes publikut.

Organizatat ndërkombëtare paraqiten si fenomen i diplomacisë publike që kanë për qëllim përpjekjet për komunikim të drejtuar nga nivele qendrore nga qeveritë e huaja⁷⁸. Organizatat politike si BE, ASEAN dhe të tjera, pavarësisht strategjive specifike që kanë për diplomacinë publike, janë përpjekur të promovojnë mirëkuptim dhe marrëdhënie të qëndrueshme mes tyre dhe audiencës së tyre duke kryer diplomaci publike⁷⁹. Prandaj organizatat shumëpalëshe ofrojnë një bazë të fortë për intensifikimin e përpjekjeve të tyre për të marrë një rol më të spikatur në botën e diplomacisë publike.

Objektivat e diplomacisë publike të organizatave ndërkombëtare janë audienca e brendshme (popullata brenda shtetit anëtar), audienca e jashtme (qeveritë e huaja dhe popullata e huaj), ose të dyja bashkë janë kontestuese dhe ngren debate.

Qëllimi i diplomacisë publike të organizatave ndërkombëtare argumentohen perceptime pozitive si siguri të aktiviteteve të tyre mes audiencës vendase brenda organizatave. Mirëpo, organizatat rajonale si NATO dhe BE, perceptojnë diplomacinë publike si një domosdoshmëri ekzistenciale dhe përqëndrojnë përpjekjet e tyre si në qasjen e tyre publike ashtu edhe në audiencën e tyre të jashtme⁸⁰. Pra, kur qeveritë kombëtare praktikojnë diplomacinë publike ato janë më të fokusuar në interesin e tyre kombëtar. Pra, kur qeveritë e përbashkëta kryejnë diplomaci publike, theksohen interesat më të gjera të atyre shteteve, rajoneve dhe botës.

Është vështirë të pretendohet se BE zhvillon një diplomaci të suksesshme publike në një mënyrë të unifikuar, pasi ka mungesë të konsensusit politik mbi objektivat dhe interesat e përgjithshme të BE-së midis shteteve anëtare të saj. NATO dhe organizatat e tjera ndërkombëtare duhet të përmbushin misionet e tyre dhe të ruajnë legjitimitetin e tyre, të respektojnë ekuilibrin e ndryshuar të ndikimit bazuar në informa

⁷⁸ Melissen, Jan "Beyond The New Public Diplomacy by Jan Melissen," 2011

⁷⁹ Dung Bui, Anh "Public Diplomacy in ASEAN and the Cases of Vietnam and Singapore", 2011.

⁸⁰ Po aty 73.

3. ARSIMI I LARTË DHE DIPLOMACIA PUBLIKE

Ekzistojnë një numër mekanizmesh të përshkruara në literaturë përmes të cilave arsimit i lartë mund të çojë në ndikim për vendin pritës në vendin e lindjes së studentëve. Aktivitetet që bien nën termin diplomaci publike janë mjete efektive të përdorura me qëllimin e ndërtimit të pushtetit të butë midis qytetarëve të vendeve të tjera. Në vitet më të fundit, roli i arsimit dhe shkëmbimit akademik në ndërtimin e marrëdhënieve ndërkombëtare është karakterizuar nga termi i pushtetit të butë. Në vend që të përdorë pushtetin, pushteti i butë varet nga forca e ideve dhe kulturës, për të ndikuar në miqësinë dhe prirjen e të tjerëve.

Arsimi i lartë është një mjet ideal për pushtet të butë. Për shumë vende drejtuese ose aspiruese të destinacionit, arsimit nuk është vetëm eksporti kryesor, por edhe një shtyllë e rëndësishme në politikën tregtare, lidhjet ndërkulturore dhe diplomacinë⁸¹. Në të njëjtën kohë, sistemi arsimor mund të përdoret si një instrument i pushtetit të butë në sferën e politikës dhe gjeopolitikës⁸². Çdo shtet është në gjendje të tregojë arritje të konsiderueshme në nivelin e prosperitetit me ndihmën e mekanizmit të zbatueshëm të sistemit arsimor. Vende si Singapori, Indonezia, Malajzia dhe vendet e tjera të Azisë Lindore mund të shërbejnë si një shembull i mrekullueshëm i kësaj⁸³. Të diplomuarit që studiojnë në vendet e huaja bëhen jo vetëm personel shumë i kualifikuar në vendet e tyre, por ata gjithashtu mund të bëhen një i ashtuquajtur "kal i Trojës"⁸⁴.

Ndërsa hyjmë në një periudhë të angazhimit të përshpejtuar global, diplomacia arsimore vend për vend po kapërcehet nga marrëdhëniet institucion më institucion dhe një grup i gjerë aktorësh. Kjo e bën skenarin e diplomacisë arsimore edhe më të ndërlikuar për ata që janë në pritje. Kjo gjithashtu do të thotë që qeveritë nuk janë aktorët kryesorë. Ndërsa qeveritë mund ta shohin veprimtarinë ndërkufitare të kolegjit dhe universitetit si një pjesë të rëndësishme të përpjekjeve të tyre diplomatike, institucionet po veprojnë gjithnjë e më shumë përtej sovranitetit, bazuar në strategjitë dhe motivimet e tyre.

Në kontekstin e diplomacisë publike, pretendohet se shkëmbimi arsimor ndërkombëtar është një mënyrë për të përmirësuar imazhin e një vendi dhe për të hedhur politikën e tij të jashtme në një dritë të favorshme. Në këtë kuptim, studentët e shkëmbimit

⁸¹ ICEF Monitor, Matja: Pjesa globale e tregut dhe synimet kombëtare në arsimin ndërkombëtar, 5 Prill, 2017

<http://monitor.icef.com/2017/04/measuring-global-market-share-national-targets-international-education/>

⁸² Amirbek, Ydyrus, Aisarbek, Kanat, Education as a Soft Power Instrument of Foreign Policy, Procedia - Social and Behavioral Sciences, 2014

⁸³ Nye, J., Soft Power and Higher Education, Harvard University, 2015, f. 14

⁸⁴ Tremblay, K., Internationalization: Shaping Strategies in the National Context, International Organizations Research Journal, 2010

zgjidhen në mënyrë që ata të jenë në gjendje të kuptojnë vendin pritës dhe të zhvillojnë simpati me sistemin politik, kulturën dhe vlerat e tij⁸⁵. Shkëmbimet janë mënyra më e mirëfilltë për qeveritë për të zhvilluar marrëdhënie të qëndrueshme me publikun e huaj, të cilat gjithashtu do të punojnë për zbatimin e suksesshëm të politikës së jashtme⁸⁶. Ky punim mbështet që duhet pasur kujdes me përgjithësimin që studentët e shkëmbimit do të përfundojnë në mënyrë të pashmangshme një program shkëmbimi me një imazh më pozitiv të vendit pritës. Në tërësi, ka një mori faktorësh që ndikojnë në këtë proces të fitimit të simpatisë dhe, për këtë arsye, është e vështirë të argumentosh kategorikisht se ‘afërsia e bën zemrën të rritet më e dashur’. Për më tepër, do të konsiderohet se zbatimi i suksesshëm i politikës së jashtme mund të lidhet përfundimisht më shumë me konvergjencën ose divergjencën e interesave midis kombeve, sesa me zhvillimin e një imazhi pozitiv përballë qeverive të tjera ose publikut të huaj.

Vendet kryesore të Anglosferës si Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar dhe Australia kanë njohur për ca kohë potencialin e pushtetit të butë të bursave dhe nismave të tjera të arsimit të lartë për të arritur një publik ndërkombëtar. Shumë nga studentët ndërkombëtarë në bursa janë udhëheqës të mundshëm të cilët përfundimisht kthehen në vendet e tyre për të marrë pozicione të larta në sektorët publik dhe privat, ku ata kontekstualizojnë dhe shpërndajnë njohuritë e marra përmes arsimit të tyre universitar. Programi Fulbright, Programet Chevening dhe Bursat e Planit Colombo janë disa nga shembujt përmes të cilave qeveritë përdorën arsimin e lartë si një model të ndihmës për zhvillimin, si dhe përhapjen e normave të tyre përmes shkëmbimit arsimor.

Vitet e fundit më shumë vëmendje i është kushtuar trendeve në ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë dhe lidhjes që ka kjo me konkursin për ndikimin global. Disa studiues përqendrohen veçanërisht te "ndikimi i kapitalit njerëzor me cilësi të lartë, rrjeti njerëzor lokal dhe global dhe kapaciteti intelektual me vlera të larta", elementet e pushtetit të butë në formimin e "një rrjeti jo-material rajonal dhe pozicioni drejtues, i cili do të zgjasë ndikimet politike, kulturore dhe shoqërore në rajon dhe më gjerë"⁸⁷. Të tjerë pranojnë zhvillimin e qendrave të arsimit si një mjet thelbësor të politikave për shtetet për të pohuar pushtetin e

⁸⁵ de Wit, H., 'Internationalization of Higher Education in the United States of America and Europe: A Historical, Comparative, and Conceptual Analysis', Greenwood Press, New York, 2002

⁸⁶ Potter, E. H., 'Canada and the new public diplomacy', Discussion Papers in Diplomacy, Issue 81, July, 20020
http://www.clingendael.nl/publications/2002/20020700_cli_paper_dip_issue81.pdf

⁸⁷ Cheney, S 2013, 'The Force of Friendly Solutions', *Challenge*, November/December 2013, f. 11-15
http://www.challenge.gov.sg/docs/default-source/magazine_archives/challenge-nov2013.pdf?sfvrsn=2

butë në një treg global gjithnjë e më konkurrues⁸⁸. Kurse disa studiues argumentojnë se Universitetet tradicionalisht janë ngritur mbi konfliktin e dhunshëm dhe ideologjik që ndodh rreth tyre për të ofruar "një perspektivë të paanshme mbi çështjet historike, politike, kulturore dhe ekonomike, ku një shkëmbim idesh, informacioni, artet dhe kultura nga njëra anë dhe efekti kaskadë i arsimit nga ana tjetër lehtësojnë performancën akademike të pushtetit të butë.⁸⁹" Kjo do të thotë që universitetet mund të shërbejnë si ura neutrale potencialisht të rëndësishme midis kombeve ndryshe jomiqësore, duke vënë në shprehje pushtetin e butë në një mënyrë delikate por të thellë.

Të konsideruara së bashku, këto tre elemente reciprociteti, diskutimi dhe ndërveprimi ndërkulturor, janë thelbësore për përdorimin e shkëmbimeve arsimore ndërkombëtare si instrumente diplomatike. Nëse sillet në diskutimin e diplomacisë publike, përbërësi i reciprocitetit i referohet idesë së procesit të dyanshëm të komunikimit në rrugë, ose, me fjalë të tjera, theksi vihet te dialogu sesa tek monologu. Komponenti i diskutimit tregon se shkëmbimet arsimore ndërkombëtare mund të menaxhohen dhe të formësohen në mënyrë që t'u shërbejnë interesave të caktuara, gjë që në rastin e qeverive është thelbësore për përmbushjen e objektivave diplomatike. Më në fund, shkëmbimet arsimore ndërkombëtare përfshijnë në mënyrë të pashmangshme ndërveprimin ndërkulturor, i cili është padyshim një instrument i fuqishëm për të gjeneruar mirëkuptim dhe për të çmitizuar imazhet.

3.1.Roli i shkëmbimeve studentore

Edukimi ndërkombëtar është një kontribues i madh i pushtetit të butë dhe si një fushë e diplomacisë publike krijon avantazhe për të prodhuar vlera dhe për të promovuar interesat dhe politikat e huaja të një vendi në zhvillim ekonomik dhe investime.

Programet ndërkombëtare arsimore në Shtete e Bashkuara u bazuan në filozofinë se: "Arsimi ndërkombëtar ishte një forcë për paqe dhe mirëkuptim reciprok dhe në fund të fundit si mjetet me të cilat Shtetet e Bashkuara mund të ndërtonin dhe ruanin ndikimin e saj në botë. Përmes këtij ndikimi, udhëheqësit botërorë të trajnuar në Shtetet e Bashkuara do të ishin më të prirur për të kuptuar dhe simpatizuar me Shtetet e Bashkuara kur kryejnë punët e tyre ndërkombëtare".⁹⁰ Pra sipas kësaj ideologjie 'paqja dhe mirëkuptimi' do të mbështesnin

⁸⁸ Mok, KH, 'The Rise of Transnational Higher Education in Asia: Student Mobility and Studying Experiences in Singapore and Malaysia', *Higher Education Policy*, 2012, f. 225-241.

⁸⁹ Deodato, E & Borkowska, I, 'Universities as actors and instruments in diplomacy – The academic soft power potential', 2014

⁹⁰ Pandit, K., Leading internationalization. *Annals of the Association of American Geographers*, 2009, f. 645-656.

sigurinë dhe politikat e huaja. Sipas Wang, arsimi ndërkombëtar ishte bërë qasje e diplomacisë publike për administrimin e reputacionit kombëtar dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.⁹¹

Me globalizimin arsimit dhe marrëdhëniet ndërkombëtare sjellin një dimension të ri të komunikimit ndërkombëtar, ku përmes institucioneve arsimore dhe shoqatave, dhe me mobilizimin e studentëve në kontekst global, kanë aftësi të zhvillojnë dhe të mbajnë lidhje të ngushta ndërshtetërore. Këto institucione përmes bashkëpunimit shkencor dhe mobilitetit akademik kontribuojnë në forcimin e marrëdhënieve ndërkombëtare midis kombeve dhe rajoneve përmes gjenerimit, shpërndarjes dhe shkëmbimit të njohurive të fituara. Arsimi i lartë është një ndër institucionet i cili ka potencial dhe luan rol kyç në zbatimin e diplomacisë publike, ku përmes shkëmbimeve akademike mund të promovohet dialogu ndërkulturor rreth ideve dhe interesave për të ndërtuar marrëdhënie të mira ndërkombëtare.

Programet shkëmbyese arsimore ndërkombëtare kanë pasuar një rritje të madhe të studentëve, sipas statistikave të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik, ku nga viti 2011 me 3.9 milion, numri është rritur në 5.3 milion studentë në 2017.⁹² Duke i'u adresuar ndryshimeve kjo sjell rritje dhe zhvillim ekonomik të vendeve.

Arsimimi si mjet i diplomacisë publike është një investim afatgjatë dhe rezultatet nuk janë të realizuara në periudhë afatshkurtë si mjetet tjera të diplomacisë publike, siq është media.⁹³ Investimet e bëra në shkëmbim arsimor ju mundësojnë shteteve të krijojnë njohje të mirë mes shoqërive, përpjekje për të tejkaluar kufijtë dhe kulturat për njohuri të reja dhe të larmishme në bazë të eksperiencave të tyre. Jo më pak rrjetet sociale si mjet të diplomacisë publike e kanë bërë më të lehtë dhe më të shpejtë komunikimin mes programeve të ndryshme ndërkombëtare, ku studentët ose shoqëritë mund të shkëmbejnë dhe zgjerojnë idetë, kulturën dhe njohuritë e tyre.

Shtetet e Bashkuara përmes praktikave të shkëmbimeve arsimore, programeve arsimore dhe organizatave joqeveritare, kanë arritur diplomaci publike me publikun e jashtëm.⁹⁴ Një ndër të është programi arsimor Fullbright, që për qëllim ka mirëkuptim reciprok në mes njerëzve dhe kombeve, megjithëse programi e ka të vështirë të fsheh

⁹¹ Wang, J., Managing national reputation and international relations in the global era: Public diplomacy revisited. *Public Relations Review*, 2006, f. 91-96.

⁹² <https://migrationdataportal.org/themes/international-students>

⁹³ Jane Wanjira Waithaka is a PhD candidate at the Institute of Diplomacy and International Studies, University of Nairobi

⁹⁴ Fulton, B., Geo-social mapping of the International Communications Environment or why Abdul isn't Listening. *The Hague Journal of Diplomacy*, 2007, f. 307-315.

interesat hegjemoniste⁹⁵ të Amerikës në përpjekejet për të zhvilluar marrëdhëniet njerëz me njerëz. Që nga krijimi i programit Fullbright të vitit 1946⁹⁶, arsimimi ka qënë një komponent kryesor për marrëdhëniet ndërkombëtare dhe diplomacinë publike. Kështu diplomacia publike mund të definohet si një mënyrë përmes së cilës diplomatët jostetëror të një kombi dhe kulture të mund të ndikojnë dhe përmirësojnë marrëdhëniet me një komb ose kulturë tjetër. Në mënyrë të ngjashme, Këshilli Britanik përshkruan rolin e tij si një organizatë ndërkombëtare për mundësi arsimimi dhe marrëdhënie kulturore, por rrallë nxjerr në pah mendimin e saj se përmes shkëmbimit akademik përmes univerzitetëve dëshiron të ushtrojë pushtetin e butë, e veçanërisht mbi vendet që Britania dikur kolonizonte.

Shërbimi Akademik i Shkëmbimit Akademik, DAAD, luan një rol të ngjashëm, por më pak të synuar. Vende të tjera evropiane, si Suedia dhe Holanda, kanë ndjekur shembujt britanikë dhe gjermanë dhe kanë krijuar agjencitë e tyre për të promovuar diplomacinë publike përmes arsimit. Qeveria Australiane pranon me gatishmëri se ka përfituar shumë nga programet e saj të ndihmës jashtë shtetit për arsimin, siç është Plani Colombo, dhe së fundmi, nisma të tilla si Australiane. Para rënies së saj, Bashkimi Sovjetik gjithashtu ofroi një numër të madh bursash studentëve nga vendet në zhvillim në përpjekje për të marrë mbështetjen e tyre në kontekstin e Luftës së Ftohtë.⁹⁷

Përveç faktit se secili shtet drejtohet nga interesat e tyre, ekziston një masë e mirë e ndërsjellë e zgjidhjeve dhe përfitimeve për të gjithë shtetet e përfshira; megjithëse përfitimet ndryshojnë midis partnerëve. Edhe pse qeveritë mund të duken pasive në disa programe arsimore, duke lejuar studentë të huaj në universitetet e tyre, kombet ndërtojnë rezervate veta të vullnetit të mirë, përmes lidhjeve të miqësisë që janë krijuar.⁹⁸

Motivimi i zakonshëm përmbas fuqisë së butë siç dihet është interesi vetanak dhe mbizotërimi përmes tërheqjes, pavarësisht nëse përfitimet janë politike, ekonomike apo për reputacion. Gjithashtu është e rëndësishme të theksohet se marrëdhëniet ndërkombëtare sot diktojnë që shtetet duhet të luftojnë për të drejtën për të përcaktuar vlerat që rregullojnë rendin e ri botëror. "Ky lloj lidhësi nuk është i mundur pa avancuar zhvillimin njerëzor bazën e formimit të ekonomisë së re të bazuar në njohuri."⁹⁹ Qeveritë atëherë kërkojnë t'u kushtojnë vëmendje sistemeve të tyre arsimore nëse janë ambiciozë në arritjen e këtij qëllimi

⁹⁵ Hegjemonike – qeverisë, udhëheqës, sundues ose mbizotërues në një kontekst politik ose shoqëror.

⁹⁶ https://en.wikipedia.org/wiki/Fulbright_Program

⁹⁷ Article: Higher Education in Southeast Asia and Beyond, The Head Foundation, 2019

⁹⁸ Nye, Joseph, Soft power and Higher Education, 2005, f.41

⁹⁹ Amirbek, Aidarbek and Ydyrys Education as a Soft Power Instrument of Foreign Policy in Procedia- Social and Behavioral Sciences, 2014, f. 502

që nga rritja ekonomike dhe sociale e një vendi varet shumë nga sistemi i tij arsimor. Programet e arsimit ndërkombëtar janë një mjet i mirë në të cilin vlerat e një kombi shpërndahen pozitivisht.

Për të pasur diplomaci publike të mirë duhet që aktorët të cilët përfshihen përmes mjeteve të cilat mundësojnë dhe nxisin angazhimin dhe bashkëpunimin në nivel individual, institucional dhe të komunitetit, duhet të kenë aftësi të mira komunikimi, aftësi të kuptojnë kulturat, qëndrimet dhe sjelljen, të ndërtojnë dhe menaxhojnë marrëdhëniet, të ndikojnë në ide dhe të mobilizojnë veprimet duke u përpjekur pë të përparuar interesat dhe vlerat e tyre.¹⁰⁰

Një sfidë tjetër e lidhur me shkëmbimet arsimore ndërkombëtare lind nga shqetësimet globale të sigurisë. Megjithatë është ironike, ndërsa nga njëra anë inkurajon shkëmbimet e arsimit si një mjet të diplomacisë publike; duhet të kërkohet një ekuilibër delikat pasi siguria kërkon një kontroll të plotë të studentëve të huaj, një kompromis i dyerve të hapura me kufij të sigurt. Nga pikëpamja kjo është ironike sepse një nga rezultatet kryesore të pritura të pushtetit të butë që përhapet në shkëmbimet arsimore është ajo e sigurisë së shtuar kombëtare, si dhe ndërkombëtare; dhe nëse nuk shqyrtohet siç duhet, sigurimi i arsimit përmes shkëmbimeve mund të ofrojë baza pjellore për pasiguri pasi shumë terroristë veprojnë nën maskën e aktiviteteve të tjera në kombet e huaja.

Edukimi është mjet për humanizëm dhe merr në konsideratë lulëzimin njerëzor dhe mirëqenien e planetit. Studentët duhet të jenë qendra e diplomacisë kulturore, përmes së cilës ju mundësohet studentëve angazhim në veprim përmes pushtetit të butë për të vendosur dialog ndërkulturor. Studentët për studime jashtë vendit duhet të zhvillojnë një ndërgjegje humaniste që shkon përtej të mësuarit për botën. “Të mësuarit global duhet të jetë jo vetëm në botë, por edhe për të. Udhëtimet arsimore duhet t'i lënë botës një vend më të qartë, më të fortë dhe më të qëndrueshëm. Ata zhvillojnë dhe mbështesin marrëdhëniet me njerëzit nga vendet pritëse përmes zhytjes kulturore dhe edukimit. Studentët që studiojnë jashtë vendit inkurajohen të pretendojnë në mënyrë aktive rolin e tyre të diplomacisë kulturore dhe në këtë mënyrë të shkaktojnë një zhvendosje nga fuqia e butë formale, e përqendruar tradicionalisht në ambasada dhe trupa diplomatike, në veprim joformal të butë në jetën e përditshme jashtë vendit. Me zhvillimin e fundit të një bollëk mundësish për studime jashtë vendit, pushteti i butë mund të konfigurohet nga studentët dhe arsimtarët që kalojnë kufijtë kombëtarë. Si

¹⁰⁰ Caitlin Byrne and Rebecca Hall Realizing Australia's International Education as Public Diplomacy, Australian Journal of International Affairs, 2013, f.425

pasojë, ata janë agjentët e mundshëm të një ndryshimi paradigme në lidhje me diplomacinë kulturore dhe arsimin ndërkombëtar: ata janë diplomatët e rinj të sotëm jozyrtarë të kulturës.

3.2.Studentët si ambasador kulturor

Duke qënë se po jetojmë në një epokë të globalizimit, pushteti i butë dhe diplomacia publike po bëhen mjete të rëndësishme në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe po bëhen përparësitë kryesore në agjendat qeveritare. Në këtë kontekst, çdo qeveri duhet të marrë parasysh imazhet e vendeve të tyre në pjesë të tjera të botës. Një imazh i saktë dhe një opinion publik pozitiv ndaj një vendi do të lehtësojë marrëdhëniet midis vendeve dhe shoqërive. Kuptimi i pushtetit të butë mund të zbatohet në mënyrë të dobishme për studentët që studiojnë jashtë kur konceptohet si qarkullim i aftësive, i zbatuar në një mënyrë të butë për një shtytje para të kuptimit ndërkombëtar. Kjo qasje për të studiuar jashtë është e lirë nga objektivat e marrjes së rezultateve të planifikuara dhe të interesuara nga të tjerët. Përkundrazi, ai ka në qendër të tij misionin humanist të kontribuojë në një komunikim më harmonik midis popujve, ndërsa interesat e tjerë kombëtarë zhvendosen në periferi. Programet e studimit jashtë vendit vendosen më pas brenda një kornize kulturore ose diplomatike qytetare, larg, megjithëse jo plotësisht të pavarur, nga synime të tilla si rritja e sigurisë sonë kombëtare dhe formësimi i lidershit tonë ndërkombëtar. Kështu, studentët për studime jashtë vendit luajnë rolin e tyre ambasadorial kulturor për të përmirësuar komunikimin dhe për të ndërtuar marrëdhënie midis individëve. Të gjitha rezultatet e tjera pozitive janë pasoja periferike dhe jo objektiva të drejtpërdrejta të programeve ndërkombëtare të arsimit.

Sipas studimit të bërë nga 50 studentë të pyetur rreth përshkrimit të ambasadorëve studentor 98% (49) prej tyre u përgjigjën se studentët që studiojnë jashtë shfaqin shumëllojshmëri dhe tregojnë se nuk kanë frikë të kërkojnë sfida të reja ose ta vendosin veten në situata të vështira.

Unë besoj se të gjithë studentët, me përgatitjen e duhur, mund të bëhen ambasadorë efektivë kulturorë, por nuk mund ta bëjnë këtë pa të. Trajnimi duhet të jetë pjesë e një strategjie të qëllimshme për t'i përgatitur ata për të promovuar vullnetin e mirë dhe mirëkuptimin përmes dialogut ndërkulturor. Përndryshe, ambasadori mbetet një element retorik i aplikimeve për studime jashtë vendit që nuk është aktualizuar në praktikë.

Për të qenë ambasadorë kulturorë studentët duhet të udhëtojnë jashtë vendit individualisht dhe jo si grup. Udhëtimet në grup modifikojnë ndërveprimin me kulturën pritëse kur një grup studentësh udhëtojnë jashtë vendit sepse grupe të çdo kombësie priren të

jenë më pak të hapur për ndërveprime me të huajt. Anëtarët e një grupi ndihen të mbrojtur dhe për këtë arsye, ata kanë një motivim të zvogëluar për të dalë jashtë rrethit mbrojtës.

Unë argumentoj që për të shërbyer si ambasadorë efektivë kulturorë, studentët e studimit jashtë vendit duhet të përfshihen në tre plane kryesore të veprimit: duke dëgjuar homologët e tyre të huaj, duke thyer stereotipet për vendet e tjera dhe duke folur në gjuhën lokal. Në këto mënyra, ata do ta vendosin konceptin e komunikimit ndër-kulturor në praktikë në jetën e tyre të përditshme përmes dialogut me njerëzit e vendit pritës. Këto aftësi të buta i pajisin ata të luajnë një rol aktiv në diplomacinë kulturore si ambasadorë studentë.

4. POLITIKAT PUBLIKE DHE SHKËMBIMET STUDENTORE NË MAQEDONINË E VERIUT

4.1. Korniza institucionale arsimore në Maqedoninë e Veriut

Ministria e Arsimit dhe Shkencës shprehu interesim të thellë dhe po mirëpret objektivat e reformës në Deklaratën e Bolonjës, komunikatën e Pragës dhe proceset shoqëruese të ndjekjes. Si kudo tjetër në Evropë, Procesi i Bolonjës në Maqedoninë e Veriut pranohet si proces i vazhdueshëm dhe gjithashtu arritje e njehershme. Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Institucioni i Arsimit të Lartë në Maqedoninë e Veriut ka prezantuar një politikë për modernizimin e arsimit që korrespondon me qëllimet e Deklaratës së Bolonjës. Shkurtimisht, objektivat kryesore të procesit të transformimit në arsimin e lartë janë: modernizimi, diversifikimi, lëvizshmëria dhe atraktiviteti i të gjithë sistemit të arsimit të lartë. Siç është përmendur tashmë, Republika e Maqedonisë së Veriut falë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës i ka përmirësuar dhe akoma po vazhdon furishëm që ti përmirëson marrëdhëniet me komunitetin arsimor evropian dhe botëror. Në të njëjtën kohë Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Institucionet e Arsimit të Lartë po punojnë në ndërtimin e strategjive efektive në zbatimin e Rekomandimeve dhe Konventave Evropiane në Sistemin e Arsimit të Lartë në Maqedoninë e Veriut. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në të gjithë Qendrën Informative për Njohjen dhe Lëvizjen e Arsimit të Lartë, si burimi kryesor i informacionit mbi Arsimin e Lartë në Evropë dhe në të gjithë botën, promovojnë dimensionin evropian në Arsimin e Lartë në Maqedoni dhe mbështesin bashkëpunimin evropian në arsimin e lartë, veçanërisht në fushën e njohjes së kualifikimeve të arsimit të lartë, akreditimin dhe sigurimin e cilësisë, si dhe lëvizshmërinë e studentëve, të diplomuarve dhe profesionistëve.¹⁰¹

Ministria fuqimisht mbështet ndërkombëtarizimin e aktiviteteve në fushën e arsimit të lartë dhe të gjitha proceset e reformimit të sistemit arsimor maqedonas në përputhje me linjat e veprimit të Bolonjës dhe veçanërisht miratimin e një sistemi të gradave lehtësisht të lexueshme dhe të krahasueshme, miratimin e sistemit bazuar në dy cikle ose strukturat bachelor / master dhe krijimi i një sistemi krediti. Republika e Maqedonisë së Veriut ka nënshkruar Konventën e Lisbonës për njohjen e kualifikimeve në lidhje me Arsimin e Lartë në rajonin Evropian në 1997 dhe gjithashtu ka ratifikuar konventën në mars 2003. Ministria

¹⁰¹ https://www.enic-naric.net/north-macedonia.aspx#anc05_50

po pranon që të dy dokumentet, si dokumente me karakteristikat kryesore të përbashkëta: bashkëpunimin dhe besimin midis sistemeve arsimore kombëtare dhe midis institucioneve të arsimit të lartë në Evropë.

Sistemi arsimor në Republikën e Maqedonisë së Veriut pasqyron nevojat e shoqërisë për rol edukativ, shkencor dhe të përhershëm të arsimit dhe shkencës për zhvillimin ekonomik, shoqëror, teknologjik dhe kulturor të shoqërisë në tërësi. Si pasojë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës lehtëson zhvillimin e vazhdueshëm të sistemit të arsimit, edukimit moral dhe shkencës në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut ekzistojnë rreth 20 institucione të arsimit të lartë, nga të cilat 6 janë universitete shtetërore dhe 14 private. Procesi i reformave filloi më intensivisht me procesin e miratimit të standardeve të Bolonjës në 2003, me zbatimin e plotë në 2004, dhe shumëzimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit. Kjo prodhoi debate mbi cilësinë e arsimit kundrejt sasisë dhe shpërndarjes së programeve të studimit nga njëra anë, dhe de monopolizimin dhe mundësinë e arritjes së arsimit të lartë nga ana tjetër. Përveç universiteteve ku procesi arsimor bazohet në gjuhën maqedonase, ekzistojnë poashtu universitete shqiptare të financuara nga shteti dhe disa private, si dhe disa universitete private turke.

Maqedonia e Veriut politikat i zbatoj lidhur me Bashkimin Evropian për të raportuar dhe për të treguar transaprency përmes reformave. E gjitha kjo ishte një përpjekje për të përforcuar demokracinë dhe sundimin e ligjit, përfshirë këtu dhe çështjet e politikës dhe legjislacionit. Duke qënë që programet evropiane janë të dizajnuara në at mënyrë që bashkëpunimi të jetë në nivel, për Maqedoninë e Veriut ky do ishte një kontribut i veçantë që do të sillte zhvillim në fushën ekonomike dhe sociale.

Politikat e arsimit të lartë në Maqedoninë e Veriut kanë të bëjnë me trendet evropiane për reformat në këtë sferë sociale. Reformat e Bolonjës filluan si një ide për të krijuar arsim të lartë gjithëpërfshirës, ku lëvizshmëria e programeve të studimit, studentëve dhe stafit akademik mund të sigurojë përdorim më cilësor dhe praktik të njohurive. Në Republikën e Maqedonisë, ky proces u përmirësua me tendencën për shpërndarje të programeve të arsimit të lartë. Ajo çka më së shumti do mbështeste vendin ishin përpjekjet për të arritur një agjendë evropiane për rritje, punësim, barazi dhe përfshirje sociale. Prandaj dhe përmes këtyre programeve me lëvizshmërinë e lirë të studentëve duke pasur parasysh këtu shpërndarjen e ideve dhe kulturave, do të ketë një bashkëpunim ndërkombëtar me shtetet Evropiane të cilat do ti ndihmojnë vendit në proceset e zhvillimit.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë së Veriut po përpiqet

të forcojë bashkëpunimin ndërkombëtar në nivelet kombëtare, institucionale dhe të projekteve. Përfshirja e shkollave, qendrave të trajnimit dhe universiteteve në shkëmbimin ndërkombëtar të studentëve, instruktorëve dhe mësuesve, si dhe ekzekutimi i projekteve ndërkombëtare, janë të një rëndësie jetike për forcimin e kapaciteteve të tyre, promovimin e "produktit" kombëtar dhe ndërkombëtarizimin e vlerave globale në proceset e integritetit.¹⁰²

Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare, OECD, Këshillin e Evropës dhe UNESCO, është veçanërisht i rëndësishëm për zhvillimin e të gjitha sistemeve arsimore: sistemi arsimor parashkollor, fillor, i mesëm, i lartë dhe i të rriturve. Republika e Maqedonisë së Veriut në dy dekadat e fundit ka zbatuar një numër programesh të BE-së në fusha të ndryshme të arsimit, përkatësisht në formën e projekteve të zhvillimit, veprimeve të bashkëpunimit dhe iniciativave të lëvizjes.¹⁰³

Lëvizshmëria e studentëve në Maqedoninë e Veriut sjell efekte pozitive në rritje akademike, zhvillim të aftësive si dhe rritjen e perspektivave në karrierë. Maqedonia e Veriut ka qasje në programe të shumta shkëmbimore që kanë të bëjnë me lëvizjen e studentëve. Mirëpo sipas një hulumtimi¹⁰⁴ të bërë ka disa faktorë të cilët tregojnë se lëvizshmëria ka efekte negative shkak i mungesës së informacionit në lidhje me këto programe shkëmbimore, mungesa e interesit të studentëve dhe frika për të shkuar jashtë të vetëm. Dhe duke u bazuar në atë hulumtim shumë studentë të cilët kanë pasur qasje në programe të tilla kanë treguar se përparimi në karrierë dhe procesi i të mësuarit ka ndryshuar ndjeshëm shkak i përvojës që kanë fituar jashtë vendit.

4.1.1. Kuadri ligjor në arsimin e lartë në Maqedoninë e Veriut

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut u jep autonomi universiteteve dhe institucioneve të arsimit të lartë. Ligji për Arsimin e Lartë thekson autonominë e universitetit dhe hyrjen e hapur nga studentët e kualifikuar në bazë të një konkursi për vendet në dispozicion. Tani ekziston një sistem i kuotave përmes së cilës një përqindje e caktuar e vendeve u ndahet pakicave etnike. Qeveria e Republikës së Maqedonisë përcakton numrin e vendeve të disponueshme të financuara nga shteti, por institucionet mund të pranojnë studentë shtesë me pagesë sipas kapacitetit dhe licencës së tyre. Studimet mund të jenë të

¹⁰² https://eacea.ec.europa.eu/national-policies/eurydice/republic-north-macedonia/mobility-and-internationalisation_es

¹⁰³ Po aty.

¹⁰⁴ Jovanovska, Mimoza, Neshkovska, Silvana, "Views on the Impact of Student Mobility on their Achievements and Future Prospects", fq 132-143. 2018

plota ose me kohë të pjesshme, ose duke mësuar në distancë. Diplomat dhe titujt specifikohen në Ligj. Studimet universitare, të shkallës së parë, Bachelor ose ekuivalente zgjasin nga katër në shtatë vjet, ndërsa arsimi i lartë "profesional", afatshkurtër mund të zgjasë më pak se dy vjet. Në shkollat e larta profesionale, studimet universitare zgjasin nga një deri në tre vjet. Të diplomuar, pas studimeve të nivelit të parë, p.sh. për një titull master ose për titull profesional pasuniversitar, organizohen sipas semestrit, me minimum tre semestra për një diplomë master. Ato bazohen në një sistem krediti. Studimet e doktoratës mund të ndërmerren pas një diplome master ose niveli ekuivalent të arsimit, duke përfshirë tezën e mbrojtur për publicitet. Studimet e doktorit të shkencave zgjasin minimumi dy vjet dhe përfshijnë një tezë.

Ligji për arsimin e lartë i kushton disa seksione çështjeve të sigurimit të cilësisë dhe njohjes së diplomave dhe titujve. Kërkesat kryesore janë për licencimin e një institucionit arsimor të lartë nga një bord i licencimit, dhe vlerësimin periodik të menaxhimit, financimit, akademik dhe aktiviteteve të tjera të tilla si kërkimi. Kjo e fundit do të realizohet përmes vlerësimit të vetë dhe të jashtëm, dhe vlerësimit të përbashkët të cilësisë së personelit akademik nga Agjencia e Arsimit të Lartë të Maqedonisë së Veriut. Përveç sigurimit të cilësisë së arsimit të dhënë për studentët në nivelin universitar, mekanizmat e sigurimit të cilësisë kanë për qëllim arritjen e standardeve evropiane dhe ndërkombëtare dhe janë përqendruar kryesisht në zhvillimin e kurrikulës dhe vlerësimin e stafit. Ekzistojnë gjithashtu plane për prezantimin e një sistemi transferimi të kredisë dhe modulizimin më të madh të kurrikulës për ta bërë sistemin më fleksibël. Sidoqoftë, mekanizmat e financimit ende bazohen në kritere sasiore sesa cilësore.¹⁰⁵

4.2. Programet shkëmbimore në Maqedoninë e Veriut

Sistemi juridik i Maqedonisë së Veriut ka një farë niveli të përgatitjes, është i përgatitur mesatarisht. Ka pasur progres të mirë në zbatimin e strategjisë së reformës gjyqësore, duke adresuar kështu Prioritetet e Reformës Urgjente dhe rekomandimet nga Komisioni i Venecias dhe Grupi i Ekspertëve të Lartë për çështjet sistematike të Sundimit të Ligjit. Akoma nevojiten përpjekje për të siguruar zbatimin sistematik të planit të përditësuar të veprimit të strategjisë së reformës gjyqësore. Si rezultat i përpjekjeve të saj për reforma në vitet e fundit, Maqedonia e Veriut ka krijuar mekanizma për të siguruar pavarësinë dhe përgjegjësinë juridike, të tilla si rregullat për emërimet e bazuara në merita, kontrollimin e

¹⁰⁵ https://www.enic-naric.net/north-macedonia.aspx#anc08_50

pasurive dhe konfliktet e interesit dhe procedurat disiplinore. Ai duhet të sigurojë përdorimin e tyre të vendosur dhe të qëndrueshëm përpara se të parashikojë ndryshime të mëtejshme në këtë fushë. Zbatimi efektiv i kornizës ligjore si dhe përpjekjet e rritura nga të gjithë aktorët për të demonstruar shembullin e tyre do të kontribuojnë në rritjen e besimit të publikut në gjyqësor.¹⁰⁶

Maqedonia e Veriut pati sukseset dhe sfidat e saj, veçanërisht në drejtim të përmbushjes së parakushteve të parashikuara administrative në lidhje me menaxhimin e pavarur, dmth. menaxhimin e decentralizuar të fondeve të BE-së. Hapat e parë në këtë drejtim u ndërmorën që në 2007 me miratimin e ligjit për themelimin e Agjencisë Kombëtare të Programeve Arsimore Evropiane dhe Lëvizshmërisë.¹⁰⁷

Duke zbatuar programet, Agjencia Kombëtare kontribuon në zhvillimin e shoqërisë së bazuar në dije, me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, punë më shumë dhe më të mira dhe kohezion më të madh shoqëror, në të njëjtën kohë duke siguruar mbrojtjen e mjedisit dhe veçanërisht shkëmbimin, bashkëpunimin dhe lëvizjen në fushat e arsimit dhe trajnimit. Përfituesit e programit janë: nxënësit, studentët, mësuesit, profesorët, arsimtarët dhe personeli tjetër i angazhuar në çdo fazë të procesit arsimor, ndërmarrjet dhe organet e tjera ligjore duke përfshirë subjektet tregtare, dhomat e tregtisë dhe shoqatat e tjera të organeve juridike në fushën e industrisë, qendrat kërkimore dhe organet, si dhe shoqatat dhe fondacionet e qytetarëve.

Në Maqedoninë e Veriut universitetet ju prezantojnë mundësitë për të realizuar lëvizshmëri jashtë vendit. Programet më të njohura janë ato të Unionit European si Erasmus+ (Skema e veprimit e Komunitetit Evropian për Lëvizjen e Studentëve të Universitetit).

Një shkëmbim universitar ndodh kur universitetet si motra tregtojnë studentë, ose përmes programeve të veçanta të tilla si Erasmus. Studentët ndjekin klasat universitare dhe shpesh jetojnë në konvikte. Këto shkëmbime mund të zgjasin diku nga një semestër i vetëm te një arsimim i tërë. Erasmus është një program shkëmbimi i Bashkimit Evropian. Ajo ka mbështetur shkëmbimin dhe lëvizshmërinë evropiane të studentëve që nga viti 1987 dhe konsiderohet si një nga programet më të suksesshme të lëvizjes ndonjëherë. Disa nga objektivat kryesore të tij janë:

- për të përmirësuar cilësinë dhe për të rritur vëllimin e mobilitetit të studentëve dhe stafit mësimdhënës në të gjithë Evropën, në mënyrë që të arrihen të paktën 3

¹⁰⁶ <https://fosm.mk/wp-content/uploads/2020/01/accession-log-9.pdf>

¹⁰⁷ Po aty.

milion shkëmbime studentësh dhe mësuesish deri në vitin 2012,

- për të përmirësuar cilësinë dhe për të rritur sasinë e bashkëpunimit shumëpalësh midis institucioneve të arsimit të lartë në Evropë,
- për të përmirësuar dhe rritur bashkëpunimin midis institucioneve të arsimit të lartë dhe ndërmarrjeve dhe,
- përhapjen e inovacionit dhe praktikave të reja pedagogjike dhe mbështetjeve midis universiteteve në Evropë.

Në 1987 kur Bashkimi Evropian kishte vetëm 12 shtete anëtare, rreth 3,000 studentë morën grante lëvizjeje për të studiuar për një periudhë prej gjashtë deri në 12 muaj në një universitet pritës në një shtet tjetër anëtar evropian. Numri i studentëve pjesëmarrës u rrit ndërsa numri i vendeve anëtare u rrit dhe deri në vitin 2000 më shumë se 100,000 studentë morën një grant ERASMUS çdo vit për të studiuar jashtë vendit. Lëvizshmëria e studentëve brenda programit ERASMUS bazohet në një numër masash që synojnë të zvogëlojnë pengesat për lëvizjen¹⁰⁸:

- Institucionet e arsimit të lartë që shkëmbejnë studentët kanë marrëveshje bashkëpunimi institucional.
- Studentët dërgohen me një marrëveshje mësimi që rregullon llojet e kurseve që ata studiojnë në universitetin pritës dhe që mbështet njohjen pas kthimit të tyre.
- Studimi jashtë vendit matet brenda kornizës së Sistemit Evropian të Transferimit të Kredive (ECTS), një sistem i akumulimit të pikës së kredisë që kontribuon në njohjen e të gjitha kurseve nga universiteti i studimeve në vendlindje.

Qendra Kassel për Kërkime mbi Arsimin e Lartë dhe Punën ka kryer disa studime¹⁰⁹ në lidhje me ndikimin dhe rezultatin e studimit të përkohshëm jashtë Evropës (brenda programit ERASMUS). Rezultatet mund të përmbliidhen si më poshtë:

- Lëvizshmëria ka një efekt “ngrohës” në arsimin pasues.
- Studentët e ERASMUS përmirësojnë aftësinë e tyre të gjuhës, zhvillojnë personalitetin e tyre dhe kulturën e rritur.
- Studentët e ERASMUS e perceptuan studimin e tyre jashtë vendit si të dobishëm për marrjen e punës së parë dhe të rëndësishme për punën.

¹⁰⁸ Teichler, U., Gordon, J., Maiworm, F., & Bradatsch, C. (2001). Das SOKRATES- Programm: Erfahrungen der ersten fünf Jahre. Kassel: Wissenschaftliches Zentrum für Berufs- und Hochschulforschung.

¹⁰⁹ Teichler, U., & Maiworm, F. (1994). Transition to Work: The Experiences of Former ERASMUS Students. London: Jessica Kingsley.

- Rezultatet gjithashtu tregojnë një ndikim të fortë të studimit jashtë vendit në lëvizjen profesionale ndërkombëtare.

Programi Erasmus në Maqedoninë e Veriut mbështetjen financiare për 2014-2020 e ka rreth 35 milione euro. Nga statistikat e dhëna nga viti 2014 deri 2019 ka në rritje të mjaftueshme të lëvizshmërisë së studentëve, për dallim nga viti 2014 ku vetëm 150 e tyre kanë studiuar jashtë vendit, në vitin 2019 janë gjithsej 318 studentë¹¹⁰. Programi Erasmus ka kontribuar dhe vazhdon të kontribuojë në rritjen e numrit të personave në Evropë të cilët janë të përgatitur dhe të gatshëm të jenë të lëvizshëm ndërkombëtarisht pas diplomimit. Studime të mëtejshme kanë treguar gjithashtu se lëvizja e studentëve dhe profesionistëve pas diplomimit kontribuon në dimensione shumë vertikale (p.sh. statusi dhe të ardhurat) e suksesit profesional, por ato kontribuojnë shumë në dimensionet horizontale (p.sh. detyrat ndërkombëtare).¹¹¹

Gjithashtu dhe programi CEEPUS (Programi i Shkëmbimit të Evropës Qendrore për Studime Universitare) bazohet në përmirësim të vazhdueshëm. Organi më i lartë i vendimmarrjes CEEPUS është Komiteti i Përbashkët i Ministrave që mbledhet një herë në vit dhe merr të gjitha vendimet strategjike. Koordinimi, vlerësimi, zhvillimi i programit dhe reklamimi janë detyrat kryesore të Zyrës Qendrore CEEPUS. Secili vend ka një Zyrë Kombëtare CEEPUS të ngarkuar me zbatimin kombëtar. Për të shmangur ngritjen e organeve të reja administrative, Zyrat Kombëtare CEEPUS janë integruar në strukturat tashmë ekzistuese, zakonisht agjencitë kombëtare.¹¹²

Me CEEPUS, nuk ka transferim fondesh: në vend të tyre ekziston një monedhë e brendshme prej "financim 1 mujor". Secili vend pagan studentët dhe mësuesit që vijnë nga vendet tjera dhe duhet të garantojnë të paktën 100 muaj bursë në vit akademik. Marrëveshja CEEPUS gjithashtu specifikon që këto grante të jenë grante gjithëpërfshirëse të lidhura me koston lokale të jetesës. Deri më tani, përvoja ka treguar se ky sistem funksionon shumë mirë. Aktiviteti kryesor i CEEPUS janë rrjetet universitare që operojnë programe të përbashkëta që çojnë idealisht në Gradë të Përbashkët, veçanërisht programet e përbashkëta të doktoratës. CEEPUS mbulon grantet e lëvizshmërisë për studentët dhe mësuesit në këtë kornizë.

Shtetet e Bashkuara gjithashtu ofrojnë programe të shumta studimi dhe shkëmbime akademike profesionale për të nxitur mirëkuptim të ndërsjellë mes Shteteve të Bashkuara dhe

¹¹⁰ <https://ec.europa.eu/assets/eac/factsheets/pdf/mk-erasmus-plus-2019-in-numbers.pdf>

¹¹¹ <https://na.org.mk/national-agency-2/>

¹¹² <https://www.ceepus.info/default.aspx?CMSPage=65#nbb>

Maqedonisë së Veriut. Të gjitha programet janë të shpallura në faqen e internetit së Ambasadës së SHBA-ve, përmes së cilës mund të informohen studentët¹¹³, si:

- Sh.B.A. Udhëzuesi i Departamentit të Shtetit për Arsimin e Lartë
- Sh.B.A. Programet e Shkëmbimit të Departamentit të Shtetit
- Instituti i Arsimit Ndërkombëtar
- Programi Fulbright Scholar
- Programi i Bursave të Hubert H. Humphrey
- Studimi i Instituteve të Shteteve të Bashkuara për Studiuesit
- Këshillat Amerikanë për Arsimin Ndërkombëtar
- Instituti Veror i Transplantikëve të Benjamin Franklin
- Programi i Zgjidhjeve të Komunitetit
- Programi Global i Shkëmbimit Universitar (Global UGRAD)

Pjesëmarrja në programet amerikane për shkëmbim është në bazë të meritave dhe çdo program ka kriteret e veta të përzgjedhjes së kandidatëve. Kandidatët vlerësohen në bazë të faktorëve si përvoja akademike, potenciali për udhëheqje, njohja e gjuhës angleze, lëmia e studimit apo hulumtimit, dhe gatishmëria për të vizituar dhe jetuar në Shtetet e Bashkuara. Programet ofrojnë mundësi të barabarta për të gjithë aplikuesit dhe nuk diskriminojnë në bazë të racës, ngjyrës së lëkurës, përkatësisë gjinore, fetare, kombëtare ose etnike, orientimit seksual apo natyrës së aftësive të kufizuara¹¹⁴.

Një program tjetër i financuar nga Shtete e Bashkuara është YES programi (Shkëmbimi dhe Studimi i të Rinjve) e cila është krijuar në vitin 2009. Byroja e Çështjeve Arsimore dhe Kulturore të Departamentit të Shtetit të SH.B.A., së bashku me komunitetin e shkëmbimit të SH.B.A.-së, njohën rëndësinë e shkëmbimit të të rinjve si një komponent kryesor për të ndërtuar ura midis shtetasve të Shteteve të Bashkuara dhe vendeve në botë, veçanërisht ato me popullsi të konsiderueshme myslimane. Programi financohet nga Departamenti i Shtetit të SHBA, Byroja e Çështjeve Arsimore dhe Kulturore (ECA) për të siguruar bursa për studentët e shkollave të mesme nga vendet me popullsi të konsiderueshme myslimane për të studiuar për një vit akademik në Shtetet e Bashkuara. Studentët PO shërbejnë si "ambasadorë të të rinjve" të vendit të tyre të lindjes, duke promovuar mirëkuptimin e ndërsjellë duke formuar marrëdhënie të qëndrueshme me familjet dhe komunitetet e tyre pritëse. Pjesëmarrësit jetojnë me një familje nikoqire, ndjekin një shkollë

¹¹³ <https://mk.usembassy.gov/sq/education-culture-sq/educational-exchange-programs-sq/>

¹¹⁴ Po aty.

të mesme amerikane, fitojnë aftësi drejtuese dhe përfshihen në aktivitete për të mësuar në lidhje me shoqërinë dhe vlerat e SHBA; ato gjithashtu ndihmojnë në edukimin e amerikanëve për vendin e tyre dhe kulturën.

Programi filloi zyrtarisht në Maqedoninë e Veriut në vitin 2009 me shpresë për të zgjeruar komunikimin midis njerëzve të Shteteve të Bashkuara dhe Maqedonisë së Veriut në mënyrë që të promovojë mirëkuptimin dhe respektin e ndërsjellë. Që nga ajo kohë, 146 studentë nga Maqedonia e Veriut kanë përfunduar programin YES dhe tani marrin pjesë si alumni.

Programi YES administrohet në partneritet me Departamentin e Shtetit të Sh.B.A-së nga një konsorcium i organizatave jofitimprurëse të drejtuara nga Këshillat Amerikanë për Arsimin Ndërkombëtar. Në Maqedoninë e Veriut, Këshillat Amerikanë për Arsimin Ndërkombëtar menaxhojnë programin YES në partneritet me Ambasadën lokale të SHBA, Zyrën e Punëve Publike.

Ambasada e Britanisë së Madhe gjithashtu ofron program shkëmbimor përmes Bursave Chevening. Chevening ofron bursa të financuara plotësisht, duke ju lënë të lirë të përqendroheshi në arritjen e qëllimeve tuaja akademike dhe të shijoni përvojën e jetës. Ju do të jetoni dhe studioni në MB për një vit, gjatë së cilës kohë do të zhvilloheni në mënyrë profesionale dhe akademike, do të rritni rrjetin tuaj, do të përjetoni kulturën në Mbretërinë e Bashkuar dhe do të ndërtoni marrëdhënie pozitive të qëndrueshme me Mbretërinë e Bashkuar.¹¹⁵

Ambasada e Gjermanisë përmes programit DAAD (Shërbimi Gjerman për Shkëmbimi Akademik) gjithashtu ofron bursa për të rinjtë e diplomuar në Maqedoninë e Veriut. Bursat jepen çdo vit nga Parlamenti Federal Gjerman (Deutsche Bundestag). Studentët kryejnë studimet për një periudhë pesë mujore në Berlin. Ata marrin pjesë në ngjarje dhe seminare gjatë kësaj kohe dhe përfundojnë një punë me një anëtar të Bundestag. Qëllimi i programit është të promovojë marrëdhëniet midis vendeve pjesëmarrëse dhe Gjermanisë, për të forcuar vullnetin dhe tolerancën demokratike, për të thelluar një kuptim të diversitetit kulturor dhe për të mbrojtur një jetë të qetë së bashku në botë. Programi është i hapur për studentë të diplomuar të rinj shumë të kualifikuar, me mendje të hapur dhe të përkushtuar me një interes të fortë në politikë nga vendet pjesëmarrëse të cilët janë të gatshëm të luajnë një rol aktiv dhe të përgjegjshëm në formësimin e të ardhmes demokratike

¹¹⁵ <https://www.chevening.org/scholarship/north-macedonia/>

të vendeve të tyre¹¹⁶.

Agjencia Turke e Bashkëpunimit dhe Zhvillimit Ndërkombëtar (TİKA) është departamenti qeveritar i Turqisë përgjegjës për shumicën e ndihmës zyrtare të Turqisë për zhvillimin e vendeve në zhvillim, duke përfshirë vendet që flasin gjuhë turke. Programet dhe buxhetet e TİKA janë rritur ndjeshëm që nga fillimi i agjencive në 2002. Fushat e veprimtarisë së TİKA janë të gjëra për të përfshirë arsimin, shëndetësinë, transportin dhe infrastrukturën sociale dhe fizike. Në lidhje me Drejtorinë e Granteve Terra Viva, Turqia financon projekte dhe trajnime në furnizimin me ujë dhe kanalizimet; energji; dhe bujqësia, blegtoria dhe mjedisi. Maqedonia e Veriut është një ndër shtetet ku Turqia financon studentët përmes programit TİKA¹¹⁷.

Zhvillimi i sektorit privat është një element kryesor për zhvillimin ekonomik pozitiv në Maqedoninë e Veriut. Lidhur me këtë, një sërë aktivitete mbështetëse nga institucione publike dhe private janë zbatuar në Maqedoninë e Veriut në bazë të 'Strategjisë Kombëtare për Zbutjen e Varfërisë dhe Përfshirjen Social 2010-2020, e cila njeh forcimin e ndërmarrësisë dhe veprimet te ekonomia informale si çështje me përparësi.

Nën mbështetje të ndryshme teknike dhe financiare për zhvillimin e sektorit privat nga këto institucione, Agjencia Ndërkombëtare e Bashkëpunimit Japonez ('JICA') e ka konsideruar zhvillimin e sektorit privat si një element thelbësor për zhvillimin ekonomik gjithëpërfshirës. JICA do të konsideronte të fillonte më shumë kontribut për këtë përmes ndihmës së mëtejshme teknike përveç përpjekjeve të mëparshme ose të vazhdueshme.

Maqedonia e Veriut, qëllimi kryesor i politikës së cilës është pranimi në BE dhe NATO, vendos zhvillimin ekonomik si përparësinë më të madhe. Janë ndërmarrë iniciativa për të stimuluar industrinë vendase dhe për të tërhequr Investime të Huaja Direkte (IHD) përmes masave preferenciale të taksave, demokratizimit dhe përmirësimeve në mjedisin e biznesit. Kriza e Eurozonës shkaktoi një rënie të eksporteve dhe IHD, por ekonomia në përgjithësi po rimëkëmbet falë efekteve të konsolidimit fiskal dhe huave të Bankës Botërore. Mbështetja e JICA për Maqedoninë e Veriut kryesisht përqendrohet në¹¹⁸:

- 1) Zhvillimin e Infrastrukturës Mjedisore dhe Rritjen e Kapacitetit të Menaxhimit, dhe
- 2) Zhvillimin e Sektorit Privat.

¹¹⁶ <https://www.daad.de/en/>

¹¹⁷ https://www.tika.gov.tr/en/page/about_us-14650

¹¹⁸ https://www.jica.go.jp/north_macedonia/english/index.html

5. STUDIMI EMPIRIK

5.1.Koncepti i lëvizshmërisë studentore si mjet i diplomacisë

Institucionet e Arsimit të Lartë krijojnë një kornizë lëvizshmërie të studentëve, stafit mësimdhënës dhe stafit administrativ kur ndërtojnë projekte të lëvizjes dhe arrijnë marrëveshje për programet e shkëmbimit.

Menaxhimi i proceseve të përfshira në këtë kornizë të lëvizshmërisë gjeneron një sasi të madhe informacionesh të përbashkëta dhe të dhënash midis institucioneve që shkëmbehen nga stafi administrativ dhe studentët. Shumica dërmuese e universiteteve evropiane përdorin një Sistem të Informacionit të Studentëve (SIS) që gjeneron të dhënat e studentëve në mënyrë dixhitale. Sidoqoftë, shkëmbimi i të dhënave midis institucioneve ende përfshin shumë dokumente fizike, gjë që e bën procesin më të komplikuar, sepse informacioni kopjohet dhe procedurat janë më të ngadalta, pasi ato kërkojnë praninë fizike të studentit për t'i dorëzuar dokumentet e nevojshme administratës.

Një nga ankesat më të shpeshta të bëra nga studentët është gjithmonë në lidhje me proceset administrative dhe burokratike me të cilat duhet të merren në mënyrë që të jenë në gjendje të shkojnë në një shkëmbim: letra motivimi, letra rekomandimi, transferimi i qëllimit të tyre akademik, njohja dhe vërtetimi e krediteve të tyre të kursit dhe përmbajtjes akademike, vërtetimi i rezultateve dhe notave të tyre akademike dhe qëndrimi në një universitet jashtë vendit, miratimi i Marrëveshjes së tyre të Mësimi, etj. Të gjitha këto procese administrative e bëjnë shumë të vështirë për studentin të thjeshtojë programin e tyre të shkëmbimit në kushtet e menaxhimit të tij administrativ. Problemet kryesore nuk janë vetëm në lidhje me proceset, por edhe në lidhje me mungesën e transferimit on-line të të dhënave akademike midis universiteteve dhe institucioneve të tjera të përfshira në të gjitha ato procese. Ajo që është më e rëndësishme është se këto nuk janë probleme të vogla për studentin që merr pjesë në një program shkëmbimi, pasi çdo gabim i bërë në këto procese mund të rezultojë në mungesë të vlefshmërisë ose nulitetit të programit të tyre të shkëmbimit, Marrëveshjes së Mësimi ose rezultateve akademike të marra jashtë vendit.

Lëvizshmëria akademike është zhvendosur nga njerëzit (studentët, fakulteti, studiuesit) në programin (binjakëzim, ekskluzivitet, virtual) dhe ofrues (degët e kampusit) lëvizshmërinë, dhe tani në qendrat arsimore. Edukimi ndërkufitar gradualisht është zhvendosur nga një kornizë bashkëpunimi zhvillimi në një model partneriteti dhe tani në një model komercial dhe konkurrues. Më detajisht, lëvizshmëria ndërkombëtare e studentëve stimulon zhvillimin e aftësive ndërkulturore dhe rrit kapacitetet e të mësuarit si të qenit

krijues, kritik dhe i aftë të gjenerojë ide të reja¹¹⁹. Një tjetër pikë kryesore është se lëvizshmëria jashtë shtetit mund të shihet si një udhëtim zbulimi i cili do të zgjerojë horizontin e studentëve dhe i bën ata të ndërtojnë rrjete profesionale.

Në Maqedoninë e Veriut sipas të dhënave statistikore zyrtare shtetërore¹²⁰ nga viti 2014 deri 2018 ka një rritje të numrit të studentëve që studiojnë jashtë vendit. Si faktor kyç parqiten universitetet të cilat ju mundësojnë studimin jashtë për një semestër. Statistikat shtetërore të cilat paraqesin regjistrimin e studentëve përgjatë vitit, tregojnë se numri i studentëve të cilët kanë studiuar jashtë vendit është rritur. Pavarësisht varitetit të numrit të studentëve i cili sa vjen dhe bie në RMV, numri i studentëve të interesuar për të kryer një semestër jashtë vendit po rritet. Në faqen zyrtare shtetërore të RMV nuk është bërë asnjë studim për studentët të cilët kanë kryer studime jashtë shtetit. Të dhënat statistikore janë marrë nga faqja zyrtare e Institutit të statistikave të UNESCO¹²¹, të cilat tregojnë monitorim ndërkombëtar të studentëve.

Viti i regjistrimit të studentëve	Numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar në RMV	Numri i studentëve jashtë vendit	%
2014	57746	3824	7%
2015	59359	4733	8%
2016	59865	5006	8%
2017	58083	5480	9%
2018	53677	5704	11%

Programet studimore shkëmbyese në RMV e kanë bërë të mundur dhe lëvizjen e studentëve si programet Erasmus dhe CEEPUS (Central European Exchange Program for University Studies), dhe programe të tjera të cilat janë një rrugë drejt zhvillimit profesional të aftësive të tyre. Studentët gjatë kësaj eksperience vizitojnë shtete të ndryshme të cilat quhen vende pritëse, dhe nga pyetësi i bërë nga 50 studentë në Maqedoninë e Veriut kishte një larmi të shteteve, si Belgjik, Gjermani, Sloveni, Austri, Itali, Republik Çeke, Turqi, Kroaci dhe vende të tjera.

Studentët kanë aftësi për të folur në gjuhë të huaja ose përpiqen të flasin rrjedhimisht gjuhët. Studimet kanë treguar se një numër i madh i studentëve preferojnë përmirësim në

¹¹⁹ Weber-Bolsey, G., Përtej zhytjes. Tek E. Jones (Ed.), Ndërkombëtarizimi dhe zëri i studentit: Perspektivat e arsimit të lartë, New York, 2010

¹²⁰ http://www.stat.gov.mk/PrethodniSooostenijaOblast_en.aspx?id=29&rbrObl=5

¹²¹ <http://data.uis.unesco.org/Index.aspx?queryid=172#>

gjuhë të huaja e cila është motiv kryesor për të marrë pjesë në programe shkëmbyese. Kjo i lejon ata të ndërveprojnë me kulturën e vendit pritës dhe të thellojnë mirëkuptimin ndërkulturor. Përtej lehtësimit të komunikimit, të folurit e gjuhës së vendit pritës u jep mundësi besimeve, vlerave, mënyrave të të menduarit dhe perceptimeve. Lidhur me përvojën e përdorimit të gjuhës në rrjetin e ri shoqëror, zhytja gjuhësore dhe ndërveprimi shoqëror në të cilin do të përfshiheshin studentët ndërkombëtarë, në një farë mase do t'i ndihmonin ata për të zbuluar një realitet të ri. Ky realitet quhet si "hapësira e tretë", ku studentët ka të ngjarë të fitojnë një hyrje në një komunitet global dhe ta përdorin atë përmes të folurit të gjuhës ndërkombëtare¹²². Sidoqoftë, studentët nga i njëjta vendlindje që janë bashkuar brenda të njëjtit kontekst ndërkombëtar mund të mos arrijnë të njëjtat rezultate siç bëjnë studentët e përzier, për shkak të rrezikut të mbetjes izoluese sesa të bashkëveprojnë me të tjerët. Studiuesi Montgomeri rreth përvojës së studentëve ndërkombëtarë raporton dy raste që ilustrojnë më tej këtë çështje. Rrjedhshmëria e gjuhës rrit potencialin e studentëve, dhe ato përpiqen të rrisin aftësitë e veta nga niveli mesatar në atë dygjuhësor. Nga 50 studentë 90% prej tyre studimin e kanë ndjekur në gjuhën angleze, por ja vlen të ceket që si mundësi të dytë për komunikim kanë pasur gjuhën frënge, gjermane dhe italiane.

Për vendin e lindjes, studentët që studiojnë jashtë mund të sjellin disa përfitime kur të kthehen në vendin e tyre të lindjes. Në fakt, nga studentët që ndoqën karrierën e tyre jashtë vendit pritës që të transmetojnë njohuritë intelektuale të fituara dhe t'i përdorin ato për të kontribuar në reformat e sistemit akademik të vendit¹²³. Po kështu, ata mund të fitojnë përvoja sociale përmes vendosjes së kontakteve shoqërore¹²⁴. Përmes vendosjes së kontakteve shoqërore me vendasit, studentët do të ishin transmetues të kulturës nga vendi pritës në atë vendas dhe anasjelltas. Për të mbështetur këtë ide, Tremblay¹²⁵ argumenton: "një periudhë studimi jashtë vendit i lejon studentët të thithin zakonet kulturore dhe shoqërore të vendit të tyre pritës dhe kështu të veprojnë si ambasador si për vendin e tyre pritës ashtu edhe për vendin e tyre".

Sipas studimit, studentët kanë dhënë një përqindje të konsiderueshme prej 94% se programet shkëmbyese i shohin si mundësi për zhvillim të horizontit të tyre, duke rritur

¹²² Montgomery, C, Preparing for life in a global community? Understanding the international student experience. Houndmills, Basingstoke, Hampshire: Palgrave Macmillan, 2010

¹²³ Arfi, K, Languages of Algerian Diaspora in the United States of America: Comparative study with Algerian diaspora in France: university of Florida, 2008


¹²⁴ Këshilli Britanik, Fillimi i një sesioni trajnimit në anglisht për të mirën e 14 mësuesve në përgatitje për rihapjen e Këshillit Britanik Shtatorin e ardhshëm Dzaers, 2014
<http://www.djazairress.com/ennahar/201097>

¹²⁵ Tremblay, K, Academic Mobility and Immigration. Journal of Studies in International Education, 2005

kështu gamën e njohurive, të kuptuarit dhe përvojës. Paralelisht ato shikojnë se mundësia e studimit jashtë do të rris mundësinë e një pune me të mirë, duke përfituar kështu eksperiencë akademike jashtë vendit, dhe duke pasur pavarësinë në një botë e cila është më pak e njohur për ato.

Se si do ta definonin edukimin ndërkombëtarë, 50% e tyre i kanë dhënë rëndësi zhvillimit të marrëdhënieve me individë nga një vend i huaj, me ndihmën e bursave, programeve të shkëmbimit ndër-tregtar, seminareve, konferencave dhe qasjes në kanalet e informacionit publik, që nënkupton komunikimin individual, bazuar në një nivel të lartë besimi, duke krijuar marrëdhënie të ngushta, e cila do të pasonte me 63% të opcionit se edukimi ndërkombëtar gjithashtu është një investues ku përvojat pozitive të marrëdhënieve shoqërore mund të shëndërrohen në vlera me ndikim dhe ide novatore për imazhin dhe interesat e vendit. Një pjesë e mirë e tyre rreth 70% mendojnë se pavarësia është ajo çka ju ndihmon studentëve për të shprehur idetë dhe mendimet e tyre gjatë eksperiencës, liria e fjalës është ajo ku një shoqëri mund të integrohet dhe adaptohet në një shoqëri tjetër multikulturore.

*** Pse keni zgjedhur të jeni pjesë e programit të shkëmbimit arsimor?**



Studentët me të mësuarit dhe njohuritë e tyre nga perspektiva të tyre i japin domethënie të ndryshme shkëmbimit arsimor duke e përshkruar atë si:

- një mundësi e mirë për investim në vete, zhvillim, përmirësim dhe ndërgjegjësim në fusha të ndryshme.
- një eksperiencë e cila të ndihmon për të qënë mendjehapur në bazë të kulturës dhe

pranimi të kulturave tjera

- një sfidë e re për tu bërë pjesë e larmishmërisë së komuniteteve ndërkombëtare,
- një përvojë që ndërton vizionin global, fitimi i pavarësisë, përmirësim i mendimit kritik dhe arritja në një nivel profesional
- përmirësim të ndjeshëm të aftësive kërkimore, komunikuese dhe prezantuese
- aftësi akademike dhe shkëmbim përvojash me studentët e vendeve tjera të huaja


Studentët luajnë një rol të rëndësishëm në leadership dhe kjo është ajo çka i motivon ato për të qenë në këtë pozitë, aftësitë e tyre për të udhëhequr grupe të ndryshme në shoqëri, universitete, shkolla, organizata joqeveritare, por qoftë edhe në punë vullnetarizmi ju ndihmon që të ndryshojnë mënyrën e të menduarit ndërkulturore. Në ditët e sodit shikojmë liderë të ri të cilët me punën e tyre arrijnë të krijojnë marrëdhënie të mira mes vendeve, popujve dhe shoqërive civile, në bazë etnike, racore e religjioze. Të paktën 80% e studentëve kanë pasur mundësinë për të qenë në pozitën e liderit dhe 30% e tyre do kishin preferuar që të kishin pozitën e liderit.

Benefitet që kanë programet shkëmbyese janë të mesuarit dhe njohuritë ndërkombëtare të cilat shtyjnë studentët drejt pranimi dhe kuptimit të një vargu perspektivash të ndryshme kulturore dhe të komunitetit, si dhe interesi në çështjet globale dhe njohuri të përgjithshme. Kjo ju mundëson studentëve për të qenë student ambasadorë të cilët përfaqësojnë jo vetëm universitetin ose shkollën që studiojnë, por edhe vendin e tyre, dhe kështu me potencialin e tyre komunikues promovojnë imazhin e universitetit dhe shkollës, por jo vetëm, gjithashtu edhe vendit të tyre nga i cili vijnë. Prandaj studentët mund të quhen si ambasadorë kulturore dhe përfaqësues të rëndësishëm në marrëdhëniet ndërkombëtare, pasi që kanë aftësitë për të ndërtuar marrëdhënie midis individëve. Dhe këto rezultate pozitive janë pasojat periferike dhe objektiva të drejtpërdrejta të programeve ndërkombëtare të arsimit.

